

DOKUMENT PËR POLITIKA nr. 6/2024

Rekomandime nga organizatat e shoqërisë civile për luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë

Shkurt 2024, Shkup

Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e Fondacionit Nacional për Demokraci të SHBA-ve dhe Institutit për demokraci "Societas Civilis" - Shkup.

Titull: Rekomandime nga organizatat e shoqërisë civile për luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë

Botues: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup

Përktheu në shqip: Vjosa Taiçi

Publikimi mund të shkarkohet falas në: <https://idscs.org.mk/mk/2024/02/28/rekomandime-nga-organizatat-e-shoqerise-civile-per-luften-kunder-korrupsionit-dhe-qeverisjes-se-mire/>

Hyrje

Ky dokument përmban gjetjet dhe rekomandimet kryesore nga organizatat e shoqërisë civile në lidhje me luftën kundër korrupsionit dhe qeverisjes së mirë. Dokumenti u drejtohet partive politike dhe synon të mbështesë procesin e krijimit të programeve për zgjedhjet e ardhshme parlamentare. Në mënyrë të veçantë, dokumenti synon të kontribuojë në krijimin e zgjidhjeve sistematike në programet zgjedhore, të forcojë angazhimet kundër korrupsionit dhe të promovojë hartimin e politikave të bazuara në prova. Në këtë drejtim, janë përfshirë gjetjet dhe rekomandimet kryesore të shoqërisë civile që synojnë problemet aktuale të korrupsionit, si dhe rekomandimet për promovimin e qeverisjes së mirë. Të dhënat janë marrë nga anketat përkatëse të organizatave të shoqërisë civile, shumica e të cilave janë anëtare të Platformës së Organizatave të Shoqërisë Civile për Luftën kundër Korrupsionit dhe Grupit Blueprint për Reformën në Drejtësi. Gjetjet dhe rekomandimet klasifikohen sipas klasifikimit zyrtar të funksioneve të qeverisë dhe i drejtohen institucioneve përkatëse të degëve legjislativë, ekzekutive dhe gjyqësore.

Përmbajtja

Hyrje	3
Lista e shkurtesave	6
1. Menaxhimi me rreziqe, integritet, gjendjen pronësore dhe interesave	8
1.1. Ndërtimi i rezistencës institucionale	8
1.1.1. Mbrojtja e sinjalizuesve	9
1.1.2. Forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullimit të lobimit.....	10
2. Financat publike.....	10
2.1. Prokurimi	10
2.1.1. Ankand elektronik	11
2.1.2. Konkurrenca dhe tregu	11
2.1.3. Monitorimi dhe administrimi i prokurimeve publike	12
2.2. Donacionet.....	13
2.3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për zbatimin e denacionalizimit	14
2.4. Përmirësimi i kuadrit ligjor për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit në fushën e shpronësimit	15
3. Sistemi i drejtësisë	16
3.1. Avancimi dhe forcimi i rolit të Këshillit Gjyqësor në luftën kundër korrupsionit	20
3.2. Përmirësimi i kapaciteteve të Prokurorisë Publike.....	21
3.3. Forcimi i kapaciteteve për zbatimin e masës së konfiskimit	23
4. Krijimi i një sistemi të bazuar në merita për menaxhim dhe punësim në sektorin publik	25
4.1. Menaxhmenti dhe strukturat udhëheqëse	25
4.2. Punësimet	26
5. Përforcimi i transparencës dhe llogaridhënies së institucioneve	29
5.1. Transparenca gjatë krijimit të politikave	30
5.2. Digjitalizimi si mjet për të zvogëluar rreziqet e korrupsionit	33
6. Rendi dhe siguria publike	34
7. Aktivitetet ekonomike	36
7.1. Qeverisja e mirë dhe reduktimi i korrupsionit në sektorin e energjisë	36
7.2. Zbulimi i ekonomisë së fshehur	39
8. Mbrojtja e mjedisit jetësor	40

8.1. Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor.....	40
9. Urbanizëm.....	44
9.1. Përmirësimi i kuadrit ligjor për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit në urbanizëm	44
9.2. Rreziqet e korrupsionit në ndërtimtari	47
10. Lista e organizatave të shoqërisë civile, gjetjet dhe rekomandimet e të cilave janë shënuar në tekst	48

Lista e shkurtesave

R2G4P	Platforma Rajonale për Partneritet Publik-Privat për Qeverisje të Mirë
AA	Agjencia për Administratë
APRMV	Agjencia për punësim e Republikës së Maqedonisë së Veriut
ACCMIS	Sistemi i informacionit për menaxhimin automatik të çështjeve gjyqësore
BPP	Byroja për Prokurime Publike
GJSRMV	Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
BDI	Inspektorati Shtetëror Administrativ
PDU	Plani i Detajuar Urbanistik
KEDNJ	Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut
RVEKR	Regjistri i vetëm elektronik kombëtar
SEFP	Sistemi Elektronik për furnizimet publike
GJEDNJ	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
BE	Bashkimi Evropian
LNA	Ligji i nëpunësve të administratës
LPSP	Ligji për punësimin në sektorin publik
BNJVL	Bashkësia e njësive të vetëqeverisjes lokale
LMJ	Ligji për mjedisin jetësor
LPP	Ligji për prokurime publike
PLKMIP	Propozim - ligj për koncesionet e mallrave me interes të përgjithshëm
LKPPL	Ligji për koncesione dhe partneritet publik privat
LPP	Ligji për procedurë penale
LPP	Ligji për Procedurë Penale
PP	Ligji për gjykatat
LKGjRMV	Ligji për Këshillin Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut
PP	Prokuroria Publike
NPPN	Ndërmarrje Publike Pyjet Nacionale
KP	Kodi penal
KLP	këshillat lokale për parandalim
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MSHIA	Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës
HCV	hidrocentrale të vegjël
OBZhE	Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik Prokuroria Publike Themelore për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe
PThP NKOK	Korrupsionit

KKP (kufizime kohore pasive)	vlerësimi i ndikimit të rregullores
KRE	Komisioni Rregullator për Energjetikë
KGJRMV	Këshilli Gjyqësor i Republikës së Maqedonisë së Veriut
PP	Policia Pyjore

1. Menaxhimi me rreziqe, integritet, gjendjen pronësore dhe interesave

Në kuadër të legjislacionit bazë kundër korrupsionit, propozohet të përsoset Ligji për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesave në lidhje me karakterin e akteve individuale të miratuara nga Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK), të ndryshohen dispozitat për trajtimin e rasteve për shqyrtimin e gjendjes pronësore të funksionarëve dhe të saktësohet lista e personave të zgjedhur dhe të emëruar¹. Rekomandohet gjithashtu të rritet politika e kundërvajtjes në ligjin bazë kundër korrupsionit dhe të rishikohen procedurat për kohëzgjatjen e hetimeve të KSHPK-së, për financimin e partive politike dhe fushatave zgjedhore².

Integriteti është një mjet i rëndësishëm për zvogëlimin e korrupsionit, por është gjithashtu më i vështiri për zbatim. Konkretisht, kodet etike të krijuara nga autoritetet ekzekutive dhe legjislative, të cilat synojnë të rrisin ndërgjegjësimin për funksionimin transparent, të përgjegjshëm dhe të ligjshëm të këtyre institucioneve, mbeten të pamjaftueshme sipas organizatave të shoqërisë civile. Theksohet nevoja për forcimin e integritetit dhe llogaridhënies në sektorin publik, me përpjekje të vazhdueshme, veçanërisht në ndërtimin e rregullave të qarta që parandalojnë konfliktin e interesit, krijimin dhe zbatimin e standardeve etike, mbrojtjen e personave që raportojnë korrupsionin, qasjen në informacion dhe transparencën në drejtim të pronësisë së funksionarëve publikë, në financimin e partive politike, disponimin e fondeve publike dhe në procedurat e miratimit të ligjeve. Kjo është gjithashtu e rëndësishme për forcimin e kapaciteteve dhe angazhimit të organeve të zbatimit të ligjit.

1.1. Ndërtimi i rezistencës institucionale

Rekomandohet kryerja e një vlerësimi të rregullt të rreziqeve për integritetin e qeverisjes qendrore, prezantimi i masave të duhura korigjuese dhe sigurimi i burimeve të përshtatshme për njësitë e kontrollit të brendshëm dhe organet përgjegjëse për këshillimin metodologjik në këtë fushë, si dhe vlerësimi i rregullt i ndikimit dhe efekteve të masave të integritetit në qeverisjen qendrore³.

¹Instituti për të Drejtat e Njeriut. 2021. *Analiza e Kornizës Ligjore Kombëtare dhe Krahasuese Relevante për Parandalimin e Korrupsionit*. Shkup: Instituti për të Drejtat e Njeriut. <https://www.ihr.org.mk/storage/app/media/Publications>.

² Bllazhevski, Teofil; Goran Rizaov. 2019. *Vlerësimi i progresit të Republikës së Maqedonisë në përmbushjen e kritereve politike të nevojshme për anëtarësimin në BE (Burimi elektronik)*. D.Z. Antikorrupsioni dhe kompromiset - Misioni i pamundur. Shkup: Fondacioni Metamorfosis. https://metamorphosis.org.mk/izdaniija_arhiva/antikorupcijata-i-kompromisite-nevozmohzha-misija/.

³ Kamilovska Trpovska, Snezhana. 2020. *Sfidat e llogaridhënies dhe integritetit të brendshëm të institucioneve me rrezik të lartë korrupsioni*. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. <https://www.antikorupcija.mk/uploads/records/file/MK%20-%202020-%20OktpWEB.pdf>.

Institucionet në fushën e antikorrupsionit duhet të përqendrohen në ndërtimin e rezistencës institucionale ndaj presioneve paralele me hierarkinë nga niveli politik. Kjo nënkupton një vlerësim të plotë dhe të vazhdueshëm të efektivitetit të procedurave antikorrupsion, kryesore për përmbushjen e kompetencave të institucioneve. Këto vegla tashmë aplikohen në institucione të caktuara në atë mënyrë që mundësojnë zbulimin e rreziqeve të korrupsionit dhe ndërtimin e planeve të integritetit. Institucionet e tjera duhet të ndjekin shembujt e mirë dhe krahas fokusit që po japin tani në përmirësimin e integritetit të punonjësve, duhet të vlerësojnë rreziqet e jashtme që vijnë nga ndikimi politik dhe të propozojnë përmirësimin e procedurave që duhet të mundësojnë funksionalisht, veprim të pavarur⁴. Për shkak të angazhimit të punonjësve në një gamë më të gjerë institucionesh të sektorit publik, është e nevojshme të miratohet një Kod etike për të gjithë punonjësit e sektorit publik, jo vetëm për nëpunësit administrativë⁵.

Institucionet duhet të përgatisin kapacitetet e tyre për mbikëqyrje, parandalim, zbulim dhe sanksionim në dy mënyra. E para është të jenë të përgatitura të parandalojnë ose sanksionojnë vendimmarrjet në nivel të lartë, që janë njollosur nga korrupsioni. Është e nevojshme t'i kushtohet vëmendje ndërtimit të kapaciteteve që do të merren me lobim dhe vendimmarrje pa analiza dhe studime adekuate. Në këtë mënyrë do të parandalohet degradimi i integritetit të procesit të vendimmarrjes, i cili lejon privilegje për kompanitë e lidhura politikisht apo subjektet e lidhura me krimin e organizuar. Aspekti i dytë është ndërtimi i kapaciteteve për kontrollin e sektorëve të veçantë, të cilët në periudhën në vijim do t'i nënshtrohen rritjes së investimeve, shpeshherë të nxitura nga përfitimet shtetërore si subvencionet dhe privatizimi, ose operimi në sektorë të kontrolluar ekonomikë bazuar në koncesione, ku do të ketë konkurrencë të kufizuar. Sektorë të tillë janë: energjetika, shfrytëzimi i lëndëve të para dhe metalurgjia, shëndetësia, si dhe privatizimi i disa shërbimeve publike. Fokus i duhet të jetë në ato institucione që vendosin për ndihmën dhe stimujt shtetërorë, për të zbatuar një proces transparent, jodiskriminues dhe efektiv të dhënies së mbështetjes, si dhe mbrojtjen e konkurrencës⁶.

1.1.1. Mbrojtja e sinjalizuesve

Ligji për mbrojtjen e sinjalizuesve u miratua në vitin 2015 me fillimin e zbatimit nga maji 2016, me ndryshime në 2018 dhe 2020. Transparency International arrin në përfundimin se vendi ka legjislacion të kënaqshëm dhe mekanizëm institucional për mbrojtjen e sinjalizuesve. Në raportin e saj, Transparency International arriti në përfundimin se ka një numër institucionesh që ende nuk kanë caktuar persona për raportim të brendshëm të mbrojtur. Për të kapërcyer mungesën e personave me certifikatë sigurie, si persona të autorizuar për raportim të brendshëm të mbrojtur,

⁴ Popoviq, Misha. *Anti-korrupsioni 2030: analizë parashikuese e sfidave të ardhshme dhe aktuale të korrupsionit*. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. <https://idscs.org.mk/en/2023/02/20/%do%b>

⁵ Qendra për Menaxhim me Ndryshime. 2018. *Analiza e Ligjit për të punësuarit në sektorin publik*. Shkup: Qendra për Menaxhim me Ndryshime. <https://cup.org.mk/publication/analysis-of-the-law-on-public-sector-employees>

⁶ Popoviq, Misha. *Anti-korrupsioni 2030: analizë parashikuese e sfidave të ardhshme dhe aktuale të korrupsionit*.

proponohet të caktohen një ose më shumë persona për pranimin e raportimeve që do të mbulonin dy ose tre institucione që janë të lidhura në fushën e tyre ose kanë afërsi gjeografike (e njëjta zonë komunale)⁷.

1.1.2. Forcimi i kuadrit ligjor dhe rregullimit të lobimit

Në kontekstin e Ligjit për lobim, analizat e organizatave të shoqërisë civile tregojnë se regjistri i mbajtur në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut është jashtëzakonisht i ulët në numrin e lobistëve të regjistruar, pavarësisht lobimit të përhapur jashtë kornizës ligjore, me interesa të fshehura të paligjshme dhe të paligjshme. Theksohet se nevojitet një përkufizim konciz i termit lobist, të cilët personat mund dhe nuk mund të jenë lobistë, duke bërë një dallim të qartë midis aktiviteteve që konsiderohen dhe atyre që nuk konsiderohen lobim. Së fundi, procedura për regjistrimin dhe regjistrimin e lobistëve duhet të bëhet më e thjeshtë me qëllim rritjen e numrit të personave që do të regjistrohen në regjistrin e lobistëve⁸.

2. Financat publike

2.1. Prokurimi

Në fushën e prokurimit publik, në përgjithësi, rekomandimet i referohen zbatimit të legjislacionit dhe miratimit të praktikave të mira antikorrupsion në planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e prokurimit publik. Një pjesë e konsiderueshme e rekomandimeve i referohen zbatimit të praktikave të mira në zbatimin e prokurimit publik. Konkretisht, Ligji për prokurimin publik (LPP) parashikon detyrimin në vendimin për prokurimin publik për të dhënë një shpjegim të nevojës për prokurim publik. Praktika tregon se ky detyrim nuk zbatohet seriozisht dhe vendimet për prokurimin publik shpesh deklarojnë vetëm një shpjegim formal. Në këtë kontekst, rekomandohet që autoritetet kontraktore t'i qasen më tërësisht vlerësimit të vlerës së prokurimit, përmes një vlerësimi më të saktë të nevojave dhe hulumtimit të tregut për të përcaktuar situatat dhe tendencat aktuale. Llogaritja e vlerës së parashikuar duhet të zgjidhet në mënyrë sistematike, jo vetëm në nivelin e një institucioni individual, por edhe në nivelin e të gjitha autoriteteve kontraktore, të cilat është e mundur të zgjidhen përmes përgatitjes së një akti nënligjor, si një lloj

⁷ Transparency International. 2022. *Raport për pesë vitet e para të zbatimit të Ligjit për mbrojtjen e sinjalizuesve: Rëndësia e këtij ligji në luftën kundër korrupsionit.* <https://transparency.mk/wp-content/uploads/2022>.

⁸Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup 2020. *Vlerësimi i Ndikimit të Rregullores në Hije - Raporti i RIA-s për Ligjin për lobimin.* Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. https://idscs.org.mk/wp-content/uploads/2020/03/5_MKD_ZAKON-ZA-LOBIRANJE.pdf

udhëzuesi me një përshkrim të detajuar të fazave dhe procedurave që do të kryhen për të vlerësuar në mënyrë përkatëse vlerën e prokurimitg.

2.1.1. Ankand elektronik

Disa nga rekomandimet i referohen aplikimit të e-ankand në prokurimin publik. Nëse, gjatë kryerjes së një prokurimi publik, autoriteti kontraktor vendos të zbatojë kriterin e përzgjedhjes sipas çmimit më të ulët, rekomandohet të mos zbatohet e-ankand, me qëllim kufizimin e mundësisë së rregullimit të çmimit fillestar të ofertës. Monitorimi i prokurimit publik tregon se ka indikacione për marrëveshje të ndërsjellë të kompanive pjesëmarrëse në e-ankand, prandaj është e nevojshme të ndiqet logjika e e-ankandit, për të aplikuar vetëm për produktet me cilësi të njohur dhe standarde dhe për të cilat ka konkurrencë në treg¹⁰.

2.1.2. Konkurrenca dhe tregu

Për të siguruar trajtim të barabartë të të gjithë pjesëmarrësve në kuadër të prokurimit publik, është e nevojshme të hartohen udhëzime më të qarta për zbatimin e nenit 10911 paragrafi 2 të LPP, për të lejuar trajtim të barabartë për të gjitha firmat dhe për të parandaluar keqpërdorimin e kësaj dispozite ligjore për të kufizuar konkurrencën dhe për të favorizuar disa ofertues¹².

Kur bëhet fjalë për thirrjet për prokurim publik, monitorimi i prokurimit publik tregon anulime të shpeshta të tenderëve të prokurimit publik, gjë që paraqet rrezik për korrupsion. Për të zvogëluar anulimet e tenderëve të prokurimit publik, është e nevojshme që institucionet të kryejnë një inspektim paraprak të tregut më shpesh, përmes të ashtuquajturit dialog teknik me kompanitë, në përputhje me nenin 7613 të LPP-së¹⁴. Gjithashtu, për një zbatim më efektiv të kuadrit ligjor për

⁹Qendra për Komunikime Qytetare 2022. *Raport nga monitorimi i prokurimeve publike, Raporti nr. 37 (korrik - dhjetor 2021)*. Shkup: Qendra për komunikime civile. <https://ccc.org.mk/images/stories/37mk.pdf>

¹⁰ Ibid.

¹¹ Neni 109, paragrafi 2 thotë: "Gjatë kontrollit të plotësisë dhe vlefshmërisë së dokumentacionit për përcaktimin e aftësisë së ofertuesit dhe gjatë vlerësimit të ofertës, komisioni mund t'u kërkojë ofertuesve sqarimin ose plotësimin e dokumenteve, nëse nuk ka devijime të konsiderueshme nga dokumentacioni i kërkuar. Komisioni nuk duhet të krijojë avantazh në favor të një operatori të caktuar ekonomik duke përdorur sqarimet ose shtesat e kërkuara " ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut " nr. 24/19 dhe 87/21).

¹²Qendra për Komunikime Qytetare 2022. *Raport nga monitorimi i prokurimeve publike, Raporti nr. 37 (korrik - dhjetor 2021)*.

¹³ Në nenin 76 të Ligjit për prokurimet publike thuhet: (1) Autoriteti kontraktor, pas miratimit të vendimit për prokurimin publik, dhe para publikimit të njoftimit për prokurimin publik, mund të zhvillojë dialog teknik me operatorët ekonomikë si më poshtë: të vërë në dispozicion të publikut përmes SEPP dokumentacionin e tenderit që planifikon të përdorë në procedurë, t'i mundësojë çdo operatori ekonomik të interesuar të bëjë propozimet dhe komentet e tij mbi dokumentacionin e publikuar të tenderit, duke përdorur mjete elektronike ose duke organizuar një takim të përbashkët në një kohë dhe datë të paracaktuar dhe të marrë në konsideratë propozimet dhe komentet e pranuar, dhe nëse është e pranueshme, t'i zbatojë ato në përputhje me rrethanat në dokumentacionin e tenderit ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 24/19 dhe 87/21)

¹⁴Qendra për Komunikime Qytetare 2022. *Raport nga monitorimi i prokurimeve publike, Raporti nr. 37 (korrik - dhjetor 2021)*.

prokurimin publik, rekomandohet një rol më aktiv i Byrosë për Prokurime Publike (LPP) në përputhje me kompetencat e saj ligjore (të përcaktuara në kuadër të LPP-së). Konkretisht, LPP duhet të shtrijë fushën e kontrollit për tenderët bazuar në një vlerësim të rrezikut ose mostër të rastësishme. Ky vlerësim i rreziqeve në "flamujt e kuq" për rrezikun e korrupsionit duhet të përfshijë gjithashtu përputhjen e vlerës së vlerësuar që nuk është shpallur publikisht me çmimin e ofruar në nivelin +/- 5%, veçanërisht kur bëhet fjalë për një ofertues të vetëm, për të përgatitur analiza vjetore të kontratave të lidhura përmes negocimit pa publikim të njoftimit të kontratës, duke treguar operatorët ekonomikë me të cilët janë lidhur kontrata të tilla, si dhe analiza vjetore të procedurave të anuluar të tenderit të prokurimit publik¹⁵.

Me qëllim lehtësimin e procedurave administrative, rekomandohet që autoritetet kontraktore në të ardhmen të mos kërkojnë nga ofertuesit garanci bankare, por të zbatojnë deklaratën e seriozitetit të ofertës. Garancia bankare duhet të zbatohet vetëm kur e kërkon vlera dhe natyra e prokurimit¹⁶.

Kur bëhet fjalë për prokurimin publik të negociuar pa një listë, rekomandohet që autoritetet kontraktore të përfshijnë sa më shumë firma të jetë e mundur. Gjithashtu, Sistemi Elektronik i Prokurimit Publik (SEPP), si dhe në faqet e tyre të internetit, duhet të publikojë menjëherë njoftimet për kontratat e lidhura, një kopje të kontratave për prokurimin publik emergjent, jo më vonë se dhjetë ditë nga data e lidhjes. Për transparencë më të madhe, institucionet duhet të përdorin instrumentin ligjor të të ashtuquajturës transparencë vullnetare dhe t'i publikojnë në SEPP vendimet për përzgjedhjen e ofertës më të favorshme në të njëjtën ditë kur informojnë ofertuesin me ofertën më të favorshme. Kontratat e prokurimit publik emergjent duhet të përmbajnë çmimet individuale të produkteve dhe shërbimeve të prokuruar, sasi të dakorduara, si dhe përshkrimin e hollësishëm të objektit të prokurimit¹⁷.

2.1.3. Monitorimi dhe administrimi i prokurimeve publike

U konstatua se një pjesë e vogël e ndërmarrjeve publike dhe shoqërive aksionare praktikojnë caktimin e një personi për të monitoruar zbatimin e kontratave. Emërimi i personave me këto përgjegjësi do të kontribuojë në monitorimin më të mirë të rrjedhës dhe zbatimit të prokurimit dhe përmbushjes së kontratave¹⁸.

Rekomandohet që politikë bërësit të sqarojnë rolet dhe të zvogëlojnë paqartësinë dhe mbivendosjen midis mandateve institucionale. Miratimi i kodit të sjelljes në prokurimin publik ose

¹⁵ Ibid.

¹⁶ Ibid.

¹⁷ Qendra për Komunikime Qytetare 2020. *Prokurimet publike gjatë koronës në Maqedoninë e Veriut: Si ishte dhe çfarë mund të bëhet në të ardhmen?* Shkup: Qendra për komunikime civile. <https://ccc.org.mk/images/stories/37mk.pdf>

¹⁸ Qendra për Komunikime Qytetare 2020. *Hartëzimi i rreziqeve të korrupsionit në prokurimet publike të ndërmarrjeve në pronësi të qeverisë dhe bashkive*. Shkup: Qendra për komunikime civile. <https://www.ccc.org.mk/images/stories/analizarizicijp.pdf>

një kod etike mund të kontribuojë në përcaktimin e udhëzimeve praktike në situatat e konfliktit të interesit ose korrupsionit. Për më tepër, është e nevojshme të forcohen kapacitetet e prokurorive publike dhe gjykatave për kërkime dhe vendimmarrje në procedura më komplekse të prokurimit publik¹⁹.

Disa vite më parë, për të përmirësuar procedurën e prokurimit publik dhe për të zvogëluar mundësinë e keqpërdorimit të mjeteve financiare, u dha një rekomandim, i cili përsëritet këtë vit, që zyrtarët për prokurim publik të jenë të detyruar të plotësojnë një deklaratë të konfliktit të interesit dhe të paraqesin listë anketuese të gjendjes pronësore. Gjithashtu përsërit rekomandimi mbi nevojën për të zbuluar publikisht pronarët e vërtetë të kompanive që kanë përfunduar prokurimin publik të sistemit elektronik të prokurimit publik, i cili do të parandalojë korrupsionin, do të zvogëlojë ndjeshëm keqpërdorimin e ofertave të prokurimit publik dhe do të shërbejë për të siguruar konkurrencë të ndershme midis ofertesve, e cila si masë parashikohet edhe në Planin e pestë Kombëtar të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (2021 – 2023)²⁰.

Gjatë situatave emergjente, transparenca më e madhe e sistemit të prokurimit publik mund të arrihet duke informuar në mënyrë adekuate dhe në kohë qytetarët për ndryshimet në legjislacionin për prokurim publik. Autoritetet për prokurim publik duhet të promovojnë transparencën dhe të përmirësojnë disponueshmërinë e të dhënave për të gjitha llojet e procedurave në faqet e internetit për e-prokurime. Në mënyrë të veçantë, procedurat e prokurimit emergjent duhet të kenë kërkesa më të rrepta të raportimit ex-post. Për më tepër, politikë bërësit duhet të mbështeten më shumë në burimet dhe aftësitë e agjencive kundër korrupsionit, organizatave të shoqërisë civile dhe portaleve të tyre. Praktikrat e prokurimit publik gjatë emergjencave duhet të kontrollohen në mënyrë specifike për çdo parregullsi dhe mashtrim²¹.

2.2. Donacionet

Sa i përket marrjes dhe përdorimit të donacioneve të destinuara për institucionet publike, analizat e organizatave të shoqërisë civile tregojnë mungesën e politikave dhe procedurave për qeverisjen e mirë dhe parandalimin e korrupsionit gjatë marrjes dhe shpenzimit të donacioneve nga institucionet publike. Në këtë drejtim, rekomandohet miratimi i standardeve për përcaktimin e justifikimit dhe përshtatshmërisë për kërkimin/ marrjen e donacioneve nga institucionet publike me parametra dhe nevoja financiare të përcaktuara saktësisht; forcimin e mekanizmave për

¹⁹ Mineva, Daniela; Vladimirov, Martin; Rangelova, Konstantsa; Fazekas, Mihaly; Hern, Peter dhe Bence Toth. 2022. *Public Procurement Integrity in Southeast Europe: Mechanisms, Red Flags, and State-Owned Enterprises in the Energy Sector*. <https://seldi.net/publications/public-procurement-integrity-in-southeast-europe-mechanisms-red-flags-and-state-owned-enterprises-in-the-energy-sector/>

²⁰Fondacioni Metamorfozis. 2023. *Vlerësimi i qeverisjes së mirë të pushtetit ekzekutiv në Maqedoninë e Veriut dhe në rajon përmes Indeksit të Hapjes*. Shkup: Fondacioni Metamorfozis. https://metamorphosis.org.mk/izdaniija_arhiva/procena-na-dobroto-vladeenije-na-izvrshnata-vlast-vo-severna-makedonija-i-vo-rajonot-preku-indeksot-na-otvorenost/.

²¹ Mineva, Daniela; Vladimirov, Martin; Rangelova, Konstantsa; Fazekas, Mihaly; Hern, Peter dhe Bence Toth. 2022. *Public Procurement Integrity in Southeast Europe: Mechanisms, Red Flags, and State-Owned Enterprises in the Energy Sector*.

monitorimin e përdorimit të donacioneve. Për të mbrojtur donatorët dhe interesin publik, të rishikohen marrëveshjet për donacione me të dhëna më të hollësishme mbi qëllimin dhe kushtet e përdorimit të donacioneve, të cilat duhet të përmbajnë klauzola për parandalimin e konfliktit të interesit, si dhe të garantojnë një shkallë të lartë llogaridhënieje për përdorimin e donacioneve nga përdoruesit fundorë. Është e nevojshme të rritet regjistrimi dhe transparenca e donacioneve duke i ndarë ato sipas llojeve të donatorëve. Evidenca e donacioneve nga qytetarët vendas dhe kompanitë që janë gjithashtu tatimpagues duhet të mbahen veçmas, me kryqëzimin e drejtpërdrejtë të donacioneve individuale (veçanërisht ato nga kompanitë) me dedikim dhe shpenzimin e mjeteve. Donacionet nga kompanitë duhet të jenë në dispozicion të publikut me vlerën e shumës, informacion të detajuar në lidhje me prokurimin (përfshirë numrin serial) dhe përdoruesin përfundimtar²².

2.3. Përmirësimi i kuadrit ligjor për zbatimin e denacionalizimit

Në analizën e kornizës ligjore për denacionalizimin dhe zbatimin e saj, organizatat e shoqërisë civile arrijnë në përfundimin se nevojiten ndryshime ligjore, të cilat do të nënkuptonin përgatitjen e një versioni zyrtar të pastruar të Ligjit për denacionalizim, ose përgatitjen e një ligji krejtësisht të ri që do të specifikonte dispozita të caktuara që paraqesin rrezik për korrupsion. Në nenin 11-a, paragrafi 4 të Ligjit, është e nevojshme të përcaktohet afat që gjykata të veprojë në rastet kur thirrja e trashëgimtarëve bëhet me shpallje dhe kur deklaratat e trashëgimisë duhet të paraqiten në një gjykatë tjetër ose jashtë vendit, gjë që do të parandalonte keqpërdorimet dhe vonesat e panevojshme të procedurave. Në nenin 12 të Ligjit është e nevojshme të vendosen dispozita në lidhje me përbërjen e komisionit për të vendosur mbi kërkesat për denacionalizim, numrin e anëtarëve dhe kushtet, përkatësisht kriteret për zgjedhjen e anëtarëve në komision. Gjithashtu në paragrafin 2, të nenit 14-a duhet të shënohen afate të sakta për veprim, pavarësisht nëse ato janë raste komplekse apo të thjeshta²³.

Me vendosjen e afateve të tilla, do të jetë e nevojshme të jepen përkufizime të sakta se cilat raste dhe në cilat situata mund të konsiderohen komplekse, nëse kompleksiteti përcaktohet me formimin e lëndës në Ministri, ose nëse është e mundur që kualifikimi të ndryshohet gjatë

22 Mitevski, Marko, Kusnikova, Nikica dhe Misha Popoviq. 2021. *Veprimet e Qeverisë gjatë gjendjes së jashtëzakonshme nga aspekti i rreziqeve nga korrupsioni në prokurimet publike, donacionet dhe ndihmën shtetërore*. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis". - Shkup. <https://www.antikorupcija.mk/uploads/records/file/Postapkite%20na%20Vladata%20KOR%202.pdf>.

23 Avramovski, Darko. 2020. *Vlerësimi anti-korrupsion i legjislacionit - raport mbi Ligjin për denacionalizim*. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis". <http://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2023/04/06-JP-BP-2020.pdf>

procedurës. Në këtë kontekst, është e nevojshme të sigurohen mekanizma mbrojtës që do të neutralizojnë tejkalimin e mundshëm të afateve të paraqitura nga organi për decentralizim²⁴.

Përfundimisht, pavarësisht nga kompleksiteti i çështjes, është e nevojshme të parashikohet në mënyrë përkatëse edhe reterimi nga rrjedha e rregullt e lëndëve, më saktësisht të përcaktohen qartë situatat në të cilat organi mund të marrë një lëndë të caktuar për ta punuar sipas rendit të pranimit, si dhe të përcaktohet afati maksimal deri kur lënda e tillë mund të mos merret për punë. Në këtë kontekst është e nevojshme të vendoset obligim për organin, të japë arsytim pse është bërë reterim nga rrjedha e rregullt e procedimit kur e njëjta është e nevojshme. Përkatësisht, në paragrafin 2 të nenit 48 është e nevojshme të përcaktohet afat ligjor në të cilin organet shtetërore, personat fizikë ose juridikë, janë të detyruar t'i paraqesin organit për decentralizim, dokumente ose prova të caktuara që ata posedojnë, të cilat janë të nevojshme për procedurën e denacionalizimit. Në këtë mënyrë, siguria juridike do të rritet, por në të njëjtën kohë do të anulohet liria për përcaktimin e afateve nga organi për denacionalizim. Neni 50 të Ligjit duhet të harmonizohet në mënyrë përkatëse me nenin 11-a për sa i përket afateve për zgjidhjen e çështjeve të mëparshme në procedurat e denacionalizimit. Për më tepër, neni duhet të harmonizohet me nenin 14-a, në lidhje me përkufizimin e lëndëve komplekse, mënyrën e marrjes së tyre për punë, me qëllim që të sigurohet afat i arsyeshëm ligjor për organin për të vepruar, i cili do të ishte mjaft i gjatë për të lejuar veprimin e duhur të trupit, por edhe arsyeshëm i shkurtër në drejtim të avancimit të të drejtave të qytetarëve në procedurat e denacionalizimit.²⁵

Përfundimisht, në nenin 59 të Ligjit për denacionalizim, ashtu si në shumicën e shembujve të mëparshëm, është e nevojshme të përkufizohen afatet ligjore për fillimin e procedurës gjyqësore për përcaktimin e ekzistimit të së drejtës së pronësisë nga personi që ka iniciuar procedurën e denacionalizimit, dhe i cili nuk ka prova për pronësinë ose akt për konfiskimin e pronës. Në këtë mënyrë, jo vetëm që parashikueshmëria dhe siguria juridike në procedura do të rriteshin, por edhe autoriteti diskrecional i organit do të neutralizohej, që në mënyrë arbitrare të përcaktojë afat për fillimin e procedurave gjyqësore.²⁶

2.4. Përmirësimi i kuadrit ligjor për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit në fushën e shpronësimit

Sipas gjetjeve të organizatave të shoqërisë civile në lidhje me kuadrin ligjor për shpronësimin, janë bërë këto rekomandime: fshirja e dispozitës në nenin 6, paragrafi 2 të Ligjit për shpronësim, i cili cenon mbrojtjen e pronës private si koncept kushtetues. Mekanizmi themelor për

²⁴ Ibid.

²⁵ Avramovski, Darko. 2020. *Vlerësimi anti-korrupsion i legjisllacionit - raport mbi Ligjin për denacionalizim*. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis".

²⁶ Ibid.

parandalimin e korrupsionit është ekzistenca e një mekanizmi represiv për të gjithë pjesëmarrësit në proces. Sipas organizatave të shoqërisë civile, Ligji për shpronësimin e përjashton këtë dhe është e nevojshme: të zbatohet një politikë penale e strukturuar për të gjithë pjesëmarrësit në proces; të përcaktohet përgjegjësia për organin që kryen shpronësimin nëse nuk është e përshtatshme; të përcaktohet përgjegjësia nëse qëllimi i shpronësimit nuk realizohet brenda një periudhe të caktuar kohore; të krijohet një procedurë që do të jetë në favor të pronarit të pronës që i nënshtrohet shpronësimit. Në mënyrë plotësuese, diskutimi për marrëveshje rregullohet në mënyrë rigjide me kompetenca diskrecionale të organit ad-hoc të refuzojë kërkesën e pronarit të pronës. Nuk ka procedurë të shkallës së dytë nëse organi e refuzon propozimin, por menjëherë vazhdon procedura gjyqësore, ndërsa kjo procedurë nuk e prolongon vendimin për shpronësim. Përfundimisht, çmimi i tregut si kompensim duhet t'i nënshtrohet ndryshimeve dhe plotësimeve, në përputhje me rrethanat reale të tregut. Kompensimet e ofruara nuk korrespondojnë me vlerën e tregut e cila konfirmohet nga aktvendimet e gjykatës që janë në përputhje me këtë këndvështrim. Ekziston nevojë urgjente për ndryshimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit të tregut që do të korrespondojë me çmimin real dhe do të jetë në dispozicion të publikut²⁷.

3. Sistemi i drejtësisë

Një numër i konsiderueshëm gjetjesh dhe rekomandimesh të organizatave të shoqërisë civile i referohen punës së prokurorisë publike dhe gjyqësorit. Një nga rekomandimet kryesore ka të bëjë me optimizimin e mëtejshëm dhe përmirësimin funksional të Sistemit Automatik të Informimit për Menaxhimin e Lëndëve (ACMIS), për sigurimin dhe përpunimin e të dhënave mbi punën e gjykatave në një shkallë më të gjerë²⁸. Përveç përmirësimit, rekomandohet që Ministria e Drejtësisë të prezantojë kontrollin e detyrueshëm dhe në kohë të sistemit ACMIS nga të gjitha organet e autorizuar²⁹.

Rekomandohet gjithashtu përmirësimi i mëtejshëm i sistemeve të digjitalizimit me qëllim regjistrimin audio-vizual të të gjitha seancave dhe braktisjen e plotë të praktikës së diktimit/parafrazimit të deklaratave nga gjyqtari³⁰.

Në lidhje me zhvillimin e procedurave, gjykatat duhet të japin shpjegime të hollësishme të vendimeve për caktimin e masës së paraburgimit. Përveç kësaj, ka nevojë të sqarohen dispozitat e

27 Kamilovska Trpovska, Snezhana. 2021. *Analizë anti-korrupsion i legjislacionit - Raport mbi Ligjin për shpronësim*. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" – Shkup. <https://www.antikorupcija.mk/uploads/records/file/6%20APL%20Извештај%20на%20Законот%20за%20експроприација%20МК.pdf>

28 Petrovska, Natali dhe Zharko Haxhi-Zafirov. 2021. *Implikimet ligjore mbi procedurat gjyqësore në rast emergjence*. Shkup: Qendra për Hulumtime dhe Analiza Ligjore. <https://all4fairtrials.org.mk/w>

29 Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike. 2020. *Plani për Përmirësim të Drejtësisë 2020-2022*. <https://shorturl.at/DFI06>

30 Petkovska, Ivana. 2021. *Monitorimi sistematik dhe tematik i proceseve gjyqësore*. Shkup: Koalicioni "Të gjithë për gjykim të drejtë" <https://all4fairtrials.org.mk/wp-content>

Ligjit për procedurën penale (LPP) në lidhje me të drejtën e mbrojtësit për më shumë të akuzuar, veçanërisht në rastin kur personat juridikë akuzohen gjithashtu midis të pandehurve³¹.

Është e nevojshme që gjykata të ofrojë një shpjegim të përshtatshëm kur bëhet një devijim nga rendi i përcaktuar ligjërisht i prodhimit të provave, me qëllim të përcaktohet proporcionaliteti midis rrezikimit të barazisë së armëve për shkak të devijimit nga rendi i prodhimit të provave me përshtatshmërinë dhe ekonominë e procedurës³². Mundësia për të lexuar deklaratat e të pandehurit nga hetimi i referuar në paragrafin 391, para. 3 i LPP-së duhet të zbatohet me shumë kujdes dhe në mënyrë kufizuese, si dhe duhet t'i jepet përparësi dispozitës së nenit 388 të LPP-së, i cili parashikon që deklaratat e bëra në procedurën e mëparshme të përdoren si argumente në provimin e tërthortë për të ashtuquajturën "freskim të kujtesës" së dëshmitarëve³³.

Lidhur me zbatimin e masave të veçanta hetimore, u konkludua se ato duhet të mbështeten në mënyrë adekuate nga të dhëna shtesë në lidhje me mënyrën e regjistrimit dhe periudhën kohore kur janë siguruar këto incizime, gjë që do të hiqte kundërshtimet se këto janë incizime të pabesueshme ose incizime nga të cilat nuk mund të përcaktohet identiteti i personave që bisedojnë³⁴.

Rekomandimet tregojnë për nevojën e zbatimit të reformave sistematike që synojnë digjitalizimin e gjykatave, specializimin e gjyqtarëve dhe uljen e vëllimit të lëndëve në gjykata, si rezultat i rritjes së përdorimit të ndërmjetësitimit dhe formave të tjera të zgjidhjes alternative të kontesteve³⁵. Në këtë kontekst, gjithashtu rekomandohet të zhvillohet një Metodologji me kritere-indikatorë për kompleksitetin e lëndëve (kjo Metodologji të ndahet nga ACMIS ose emërtimi në AKMIS të mos jetë kriter në përcaktimin e kompleksitetit të lëndës). Së fundi, rekomandohet miratimi i një Plani dhe përcaktimi i procedurave për rrjedhën dhe lëvizjen e lëndëve gjyqësore në përputhje me Ligjin e ri për menaxhimin e lëvizjes së lëndëve³⁶.

Organizatave të shoqërisë civile theksojnë nevojën e zbatimit aktiv të dispozitave të ligjit në lidhje me institutin "përrjashtim" për kërkesat ligjore të përmbushura më parë. Gjithashtu, i referohet nevojës për ndryshime të dispozitave në ligjet procedurale që rregullojnë shkaqet e bazave të ankimit në mënyrë të tillë që shkelja e parimit të "gjyqtarit natyror" do të jetë bazë për ankimimin e një vendimi³⁷.

31 Kamilovska Trpovska, Snezhana, Filkov, German dhe Gordan Kallajxhiev. 2021. *Monitorimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve në trajtimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit*. Shkup: Shoqata për Iniciativë Demokratike, Koalicioni i Shoqatave të Qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë".

32 Avramovski, Darko, Petkovska, Ivana, dhe Lejla Tutiq. 2022. *Analiza e të dhënave nga procedurat gjyqësore të monitoruara në lidhje me krimin e organizuar dhe korrupsionin në vitin 2022*. Shkup: Koalicioni i shoqatave qytetare "Të gjithë për gjykim të drejtë" <https://all4fairtrials.org.mk/wp->

33 Kamilovska Trpovska, Snezhana, Filkov, German dhe Gordan Kallajxhiev. 2021. *Monitorimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve në trajtimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit*.

34 Ibid.

35 Dellovski, Velimir, Gruevska, Sonja, Sandra Buzlieva. 2022. *Dokument për politika për transparencën, llogaridhënien dhe efektivitetin e gjyqësorit me fokus mbi punën e gjykatave dhe administratës gjyqësore*. Shkup: Instituti për të Drejtat e Njeriut, Qendra për Kërkime dhe Analiza Ligjore. <https://cpia.mk/wp-content/uploads>

36 Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike. 2020. *Plan për Përmirësim të Drejtësisë 2020-2022*.

37 Ibid.

Rekomandohet rishikimi i Ligjit për shërbimin gjyqësor dhe në të në mënyrë sistemore të rregullohen të gjitha çështjet në lidhje me statusin e shërbimit gjyqësor, duke përfshirë çështjet e transparencës, llogaridhënies dhe efektivitetit, me përjashtim të nëpunësve gjyqësorë nga Ligji për nëpunësit administrativ dhe Ligji për të punësuarit në sektorin publik, si dhe miratimin e akteve nënligjore të përshtatshme³⁸.

Në kuadër të zgjedhjes së gjyqtarëve, është e nevojshme të ndryshohen aktet nënligjore për mënyrën e kryerjes së testit të integritetit, veçanërisht në Rregulloren për mënyrën dhe formën e kryerjes së testit psikologjik dhe testit të integritetit. Është e nevojshme të bëhen ndryshime për të përmirësuar këtë kuadër dhe rregullat për kryerjen e testit, me qëllim parandalimin e keqpërdorimit të mundshëm dhe konfliktit të interesit, si gjatë përzgjedhjes së subjektit dhe përcaktimit të shumës së tarifës për kryerjen e testit, ashtu edhe në drejtim të eliminimit të rreziqeve të korrupsionit gjatë marrjes së provimeve dhe vlerësimit dhe rangimit të kandidatëve që kalojnë këto teste³⁹. Metodologjitë për vlerësimin e gjyqtarëve duhet të monitorohen dhe vlerësohen vazhdimisht, ndërsa kjo përfshin pikëpamjet dhe mendimet e gjyqtarëve për mënyrën në të cilën kryhet vlerësimi⁴⁰. Rekomandohet miratimi i aktit nënligjor - Rregullore për përcaktimin e kritereve për zgjedhje transparente dhe objektive të gjyqtarëve⁴¹.

Procesi i vetingut në gjyqësor duhet të ketë një qasje gjithëpërfshirëse, nga plotësimi i kuadrit ligjor dhe strukturës organizative, deri në vendosjen e procedurave që i nënshtrohen rregullave, parimeve dhe standardeve të përcaktuara rreptësisht që do të garantojnë një proces të bazuar në merita me qëllim parandalimin e kërcënimeve të mundshme nga ndikimet politike dhe ndikime të tjera në gjyqësor⁴². Sipas rekomandimeve të Qendrës për Kërkime dhe Analiza Ligjore, procesi i verifikimit në gjyqësor duhet të kryhet përmes një sistemi objektiv që duhet të mbulojë aspektet e mëposhtme⁴³:

- a. Të zbatohet nga një organ i veçantë në përputhje me parimet e Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ) dhe praktikës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ);
- b. Të përcaktohet objekti i vetingut, përkatësisht afati kohor i kontrollit;
- c. Të përcaktohet numri i personave që do të mbulohen nga kontrolli;
- d. Të parashikohet kohëzgjatja e procesit;
- e. Të krijohet kuadri ligjor dhe të përcaktohet krijimi i organeve që do ta zbatonin atë;

³⁸ Stojkova-Zafirovska, Lidija, Haxhi-Zafirov, Zharko, Martin Sopronov. 2018. *Kontroll i gjykatësve në demokracitë e reja: një analizë krahasuese e mekanizmave të shqyrtimit gjyqësor në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi dhe Maqedoni*. Shkup: Qendra për Hulumtime dhe Analiza Ligjore - Shkup. <https://cpia.mk/wp-content/uploads/2021/10/3.pdf>

³⁹ Kamillovska Trpovska, Snezhana, Filkov, German dhe Gordan Kallajxhiev. 2021. *Monitorimi dhe përmirësimi i kapaciteteve të institucioneve në trajtimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit*.

⁴⁰ Petrovska, Natali, Darko Avramovski. 2021. *Ndikimi i sistemit të meritave mbi pavarësinë gjyqësore dhe profesionalizmin në Maqedoninë e Veriut*. Shkup: Koalicioni i shoqatave qytetare "Të gjithë për gjykim të drejtë" - Shkup. <https://all4fairtrials.org.mk/wp-content>

⁴¹ Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike. 2020. *Plan për Përmirësim të Drejtësisë 2020-2022*.

⁴² Blueprint grupi për reforma në drejtësi. 2020. *Procesi i vetingut në gjyqësorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut*. <https://all4fairtrials.org.mk>

⁴³ Ibid.

- f. Vendosja e rregullave të procedurës (roli i institucioneve dhe organeve që do të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje në procesin e vërtetimit të informacioneve për personat);
- g. Të përcaktohen kritere të qarta për shqyrtimin e gjyqtarëve;
- h. Të vendoset një sistem monitorimi të procesit të rivlerësimit.

Kur bëhet fjalë për shkarkimin e gjyqtarëve, është veçanërisht e rëndësishme të ndryshohet praktika e publikimit të emrave të gjyqtarëve të shkarkuar në vend të shpjegimeve të vendimeve për shkarkim. Nga pikëpamja e kontrollit publik mbi punën e gjyqësorit, është shumë më e rëndësishme që opinioni ekspert dhe publiku i gjerë të jenë të vetëdijshëm për arsyet e shkarkimit të gjyqtarit, si dhe argumentimin e duhur të ofruar nga Këshilli Gjyqësor për të mbështetur vendimin e tij. Është e nevojshme të merret në konsideratë mundësia e vendosjes së përsëritjes së procedurave në rastet kur do të vërtetohet se nuk ka pasur arsye për pushimin nga puna⁴⁴. Rekomandohet miratimi i aktit nënligjor - Rregullore për përcaktimin e kritereve dhe kushteve për shkarkim nga detyra gjyqësore për shkak të kryerjes së shkeljes së rëndë disiplinore, kritereve për kryerjen joprofesionale dhe neglizhente të punës, si dhe përcaktimi i fazave të procedurës disiplinore dhe autoritetit vendimmarrës (neni 60 i LPCRM-së dhe neni 74 i LGj-së), miratimi i Rregullores për përcaktimin e kritereve për procedurë disiplinore në përputhje me standardet e GJEDNJ-së (neni 28 i Rregullores së punës dhe neni 34.35 i LPCRM-së), si dhe përcaktimi i termit "neglizhencë e qëllimshme ose e dukshme" - ndryshimi i një dispozite të ligjit (neni 34 i LPRMV-së dhe neni 74 i LGj-së)⁴⁵.

Rekomandohet rishikimi i arsytimit të vendimeve gjyqësore duke përpunuar një doktrinë të re sipas parimeve të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë dhe GJEDNJ-së, si dhe miratimi i një metodologjie për cilësinë e drejtësisë gjyqësore nga Gjykata Supreme.

Së fundi, organizatat e shoqërisë civile rekomandojnë centralizimin e prokurimit dhe punësimit në gjyqësor; ndërsa menaxhimi i buxhetit të gjykatave të transferohet në juridiksionin e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut (GjSRMV)⁴⁶. Megjithatë, konkludohet se si të gjyqësori ashtu edhe të prokuroria nuk bëhet fjalë për buxhete zhvillimore, përkatësisht shumica e mjeteve shpenzohen për paga, gjë që e bën të pamundur zbatimin e reformave, që nënkupton përmirësimin e hetimeve me Prokurorinë Publike (PTh) dhe pavarësinë dhe efikasitetin e gjyqësorit⁴⁷.

⁴⁴ Petrovska, Natali, Darko Avramovski. 2021. *Ndikimi i sistemit të meritave mbi pavarësinë gjyqësore dhe profesionalizmin në Maqedoninë e Veriut*.

⁴⁵ Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike. 2020. *Plan për Përmirësim të Drejtësisë 2020-2022*.

⁴⁶ Ibid.

⁴⁷ Blazhevski, Teofil. 2022. *Monitorimi i procesit të integritetit evropian: reformat në gjyqësor*. Shkup: Fondacioni Metamorfozis. https://metamorphosis.org.mk/izdaniija_arhiva/sledenje-na-procesot-na-evrointegracii-reformi-vo-pravosudstvo/

3.1. Avancimi dhe forcimi i rolit të Këshillit Gjyqësor në luftën kundër korrupsionit

Kuvendi i Maqedonisë së Veriut duhet të sigurojë kritere të qarta dhe procedura transparente për emërimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor të cilët nuk zgjidhen nga radhët e gjyqtarëve⁴⁸. Nevojiten ndryshime në LKGJRMV, me qëllim përcaktimin e censusit, përkatësisht pjesëmarrjen e gjyqtarëve në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor (KGJRMV), si dhe përcaktimin e shumicës me të cilën kandidati/ja konsiderohet i/e zgjedhur⁴⁹.

Kur bëhet fjalë për punën e KGJRMV-së, organizatat e shoqërisë civile rekomandojnë promovimin e transparencës në punën e Këshillit, si dhe drejtimin e kapaciteteve për të rritur besimin e qytetarëve në gjyqësor përmes shkëmbimit proaktiv të informacionit publik dhe komunikimit me publikun⁵⁰. Rekomandohet braktisja e praktikës së mbajtjes së kolegjiut me dyer të mbyllura të KGJRMV-së, menjëherë para mbajtjes së seancave dhe shpjegimit të plotë të ankesave, duke argumentuar arsyet pas një votimi të caktuar⁵¹.

Është e nevojshme të bëhet dallimi i duhur ligjor midis procedurave për ankesat dhe procedurave për përcaktimin e përgjegjesisë së gjyqtarit. Gjithashtu, është e nevojshme që KGJRMV-ja, të ketë një bazë të dhënash statistikore që do t'i referohej numrit të ankesave të paraqitura ndaj secilit gjyqtar individualisht, arsyeve mbi të cilat janë paraqitur ankesat, si dhe rezultatit të procedurave të ankesave⁵². Kjo ka për qëllim ndërtimin e një sistemi solid dhe të qartë për llogaridhënien disiplinore të gjyqtarëve në kuadër të KGJRMV-së, i cili do të përgjigjej në mënyrë të drejtë dhe të shpejtë nëse parashtrohet ankesë me dyshime për korrupsion, te një gjyqtar i caktuar⁵³.

Anëtarët e KGJRMV -së duhet të zbatojnë vazhdimisht dispozitat e LKGJRMV-së, gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve dhe/ose kryetarëve të gjykatave, veçanërisht kur është zhvilluar e gjithë procedura, dhe disa anëtarë të GJSRMV-së duhet të argumentojnë për cilat arsye nuk kanë votuar për asnjë kandidat. KGJRMV duhet të zbatojë vazhdimisht rezultatet e listës së vlerësimit dhe rang listën gjatë zgjedhjes së gjyqtarëve në gjykatat më të larta⁵⁴.

KGJRMV dhe Këshilli i Prokurorëve Publikë duhet të përmirësojnë zbatimin e masave për integritetin e gjyqtarëve dhe prokurorëve. Nevojiten ndryshime legjislative për rregullimin e

¹¹² Mihailova, Vanja. 2022. *Analiza e dokumenteve kombëtare të rëndësishme për luftën kundër korrupsionit*.

¹¹³ Karcicka-Vasilevska, Rosalija. 2019. *Si të përmirësohen shërbimet publike për qytetarët: dokument për promovimin e politikave publike*.

¹¹⁴ Ibid.

¹¹⁵ Stojanovski, Aleksandar; Angelevska, Kristina dhe Dimitar Nikolovski. 2022. *Gjithëpërfshirja në vendimmarrje në punën e policisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Shkup: EUROTINK - Qendra për Strategji Evropiane - Shkup.

për veprim të përbashkët të grupeve të ndryshme të palëve të interesuara në fushën e sigurisë publike, duke siguruar ndërhyrje multidisiplinare për problemet lokale¹¹⁶.

Kur bëhet fjalë për klasifikimin e informacioneve, organizatat e shoqërisë civile tregojnë se ndërsa është vërtetuar se disa informacione mund të ruhen nga publiku, ekzistojnë standarde se si shtetet duhet të klasifikojnë informacionet. Para së gjithash, ajo që klasifikohet duhet të jenë informacione, jo dokumente. Në këtë mënyrë, do të ishte e mundur të zbuloheshin dokumentet duke redaktuar seksionet që përmbajnë informacion konfidencial dhe duke vënë pjesën tjetër të dokumentit në dispozicion të publikut. Parimet e Tshwane (2013) përfshijnë standarde shtesë të detajuara të klasifikimit, duke përfshirë, ndër të tjera, detyrimin e qeverisë për të deklaruar arsyet për klasifikimin (Parimi 11), qasjen e publikut në procedurat që rregullojnë klasifikimin (Parimi 12), afatet kohore për periudhën e klasifikimit dhe rishikimin periodik të vendimeve për informacionin e ruajtur (Parimi 16)¹¹⁷.

Lidhur me raportet publike vjetore të shërbimeve të sigurisë, megjithëse nuk ka një standard të njohur ndërkombëtar për përmbajtjen dhe kohëzgjatjen e raporteve vjetore për institucionet e sigurisë, praktika e mirë sugjeron që një raport i tillë duhet të përfshijë:

- prioritetet kryesore të institucionit të sigurisë;
- shqyrtimin e kërcënimeve të mëdha të sigurisë;
- ndryshime të rëndësishme në politikat e sigurisë/inteligjencës;
- informacion dhe statistika për aspekte që nënkuptojnë llogaridhënie, duke përfshirë përgjigjen e saj ndaj kërkesave për qasje në informacion¹¹⁸.

Rekomandohet gjithashtu krijimi i një organi të veçantë mbikëqyrës, të pavarur nga parlamenti, për mbikëqyrje efektive dhe të paanshme të agjencive të kundërzbulimit. Anëtarët e organit mbikëqyrës kërkojnë përvojë të konsiderueshme në fushat e sigurisë kombëtare, duke përfshirë juristë, ish-gjyqtarë, prokurorë dhe të drejtat e njeriut. Anëtarët duhet të emërohen përmes një procesi transparent, siç është një konkurs publik, për të siguruar kualifikimin dhe konfidencialitetin e tyre. Organi mbikëqyrës duhet të ketë sekretariatit e vet të personave të trajnuar përgjegjës për aspekte të ndryshme të mbikëqyrjes, duke përfshirë financat, mbledhjen e të dhënave dhe analizën¹¹⁹. Ekziston nevoja që MPB të përmirësojë transparencën pasive, përmes kategorizimit të përmirësuar të postimeve, dokumenteve dhe informacionit në faqen e saj të internetit, të cilat lidhen me punën dhe rezultatet e punës, dhe janë të detyrueshme dhe lindin nga ligjet dhe procedurat e brendshme për punë (raportet vjetore, strategjitë, njoftimet për konkurse

¹¹⁶ Stojanovski, Aleksandar; Krushkarovska, Frosina; dhe Dimitar Nikolovski. 2023. *Këshillat lokalë të parandalimit për bashkëpunim të zgjeruar lokal*. Shkup: EUROTINK - Qendra për Strategji Evropiane - Shkup.

¹¹⁷ Stojanovski, Aleksandar; 2022. *Analiza e politikave publike: Transparenca e shërbimeve sekrete në Mbretërinë e Bashkuar, Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe Republikën e Sllovenisë*. Shkup: EUROTINK - Qendra për Strategji Evropiane - Shkup.

¹¹⁸ Ibid.

¹¹⁹ Lembovska, Magdalena; Stefanovski, Ivan; dhe Aleksandar Stojanovski, 2021. *Rimendimi i mbikëqyrjes demokratike të shërbimeve të sigurisë dhe inteligjencës në Maqedoninë e Veriut*. Eurothink-Centre for European Strategies, <https://eurothink.mk/wp-content/uploads/2021/03/09.03.2021-mk-verzija.pdf>

dhe prokurime publike, etj.); si dhe të mundësojë kërkimin e informacioneve të publikuara në faqen e internetit¹²⁰.

7. Aktivitetet ekonomike

7.1. Qeverisja e mirë dhe reduktimi i korrupsionit në sektorin e energjisë

Zhvillimi ekonomik i bazuar në përdorimin e burimeve natyrore duhet në mënyrë të pashmangshme të përputhet me qëllimet dhe angazhimet për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile theksojnë nevojën për të bërë përpjekje më të mëdha në përgatitjen e dokumenteve të rëndësishme strategjike - Plani Kombëtar i Veprimit për Mjedisin Jetësor, Bazat e Ekonomisë Ujore, Planet e Menaxhimit të Rrjedhave Lumore, Plani Pesëvjeçar për Zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Mbrojtjen e Natyrës, Programi për Zbatimin e Strategjisë për Energji të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Plani i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme¹²¹, të cilat gjithashtu kanë implikime për përdorimin e këtyre burimeve për prodhimin e energjisë.

Nga analiza e kornizës ligjore për energjetikë, organizatat e shoqërisë civile konkludojnë se pushteti ekzekutiv dhe Komisioni Rregullator i Energjisë (KRE) kanë kompetenca të gjera, ku rreziqet e korrupsionit identifikohen në kontekstin e shpërndarjes së disa dispozitave përkatëse përmes rregulloreve përkatëse, duke përfshirë tre ligje, dhjetëra akte nënligjore, një dekret qeveritar dhe disa rregullore të ministrive kompetente dhe KRE. Në këtë kontekst, rekomandohet të bëhen përpjekje për të mundësuar kodifikimin e duhur të të gjitha rregulloreve që lidhen me energjetikën në një akt, ose ndarjen dhe grupimin e duhur të dispozitave të veçanta në disa ligje të ndryshme. Për të parandaluar rrezikun shtesë nga korrupsioni, rekomandohet të ndryshohet neni 22 i Ligjit për energjetikë, në mënyrë që të mundësohet pajtueshmëri e plotë me dispozitat e Ligjit për parandalimin e korrupsionit dhe konfliktit të interesit. Përkatësisht, rekomandohet që në nenin 22, pika 1, si persona të afërt të kryetarit, anëtarë dhe punonjës të shërbimit profesional të KRE-së, partnerë jashtëmartesorë, të afërm të gjakut në vijë të drejtë dhe në vijë anësore deri në shkallën

¹²⁰ Stojanovski, Aleksandar; Angelevska, Kristina dhe Dimitar Nikolovski. 2022. *Transparenca në punën e policisë në Republikën e Maqedonisë së Veriut*, Shkup: EUROTINK – Qendra për Strategji Evropiane –Shkup <https://eurothink.mk/wp-content/uploads/2022/09/%D0%A2%D1%80%D0%B0%BD%>

¹²¹ Trpevski, Bojan; Çolloviq - Leshoska, AKSH; Gjorgji Mitrevski. 2022. *Analiza e funksionimit të hidrocentraleve të vegjël*. Shkup: Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj, Shkup. <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022/06/MZMP-Analiza-MHE.pdf>

e katërt, të afërm me martesë deri në shkallën e dytë, si dhe të shtohet çdo person fizik ose juridik me të cilin kryetari, anëtarët dhe punonjësit e KRE-së kanë interes financiar¹²².

Analiza e kryer nga Platforma Rajonale për Partneritet Publik-Privat për Qeverisje të Mirë (R2G4P) tregoi se në vendet e Evropës Juglindore, përfshirë Maqedoninë e Veriut, menaxhimi i ndërmarrjeve publike në sektorin e energjisë në rajon nuk është në përputhje me praktikën dhe standardet më të mira ndërkombëtare. Janë konstatuar mangësi të transparencës dhe një arsye e qartë për vendimet për investimet në energji, qeverisjen, vetëmërimin dhe vendimet për çmimet. Për më tepër, ndryshimet ligjore dhe vendimet strategjike në sektorin e energjisë bëhen me dyer të mbyllura, pa debat të gjerë publik ose konsultime me ekspertë. Në këtë kontekst, janë dhënë rekomandimet e mëposhtme:

- Çrrënjësja e rreziqeve nga korrupsioni dhe kapja e shtetit duke eliminuar subvencionet që rrënojnë tregun, ndarja e partive politike nga udhëheqja e ndërmarrjeve publike dhe përmirësimi i procedurave të rekrutimit të stafit me qëllim profesionalizimin e menaxhimit në sektorin e energjisë.
- Komisionet parlamentare duhet të urdhërojnë rishikime të pavarura vjetore të politikave, të cilat duhet të përmbajnë: a) vlerësim të performancës së politikës energjetike kundrejt prioritetëve të përcaktuara vjetore, buxhetit të programuar dhe objektivave strategjikë; b) vlerësim të situatës financiare të ndërmarrjeve publike dhe identifikimin e rreziqeve për zhvillimin e sektorit, përfshirë garancitë e nevojshme shtetërore dhe rreziqet e privatizimit të fshehur; c) draft të fushave prioritare për politikën energjetike për vitin e ardhshëm.
- Të avancohet pavarësia e organeve rregullatore kombëtare duke rritur kapacitetin e tyre administrativ dhe financiar dhe duke hequr emërimet politike që nuk janë në përputhje me nivelet më të larta të masave kundër konfliktit të interesit dhe standardeve të kriterëve teknike;
- Të harmonizohet kuadri ligjor dhe praktika në ndërmarrjet publike në sektorin e energjisë me Udhëzimet e OECD-së për Qeverisjen e Korporatave të Ndërmarrjeve Publike, të cilat përfshijnë rregulla dhe praktika të qarta që sigurojnë:
 - Autonomi operacionale të ndërmarrjeve publike në sektorin e energjisë, pavarësi të bordeve të tyre nga ndikimi politik dhe emërimet e bazuara në merita;
 - Transparencë të plotë dhe publikim të informacioneve përkatëse financiare dhe jofinanciare, duke përfshirë por pa u kufizuar në publikimin në kohë, të rregullt të raporteve të detajuara financiare, publikimin e strukturës së menaxhimit të ndërmarrjeve, objektivat e ndërmarrjes dhe planin për zbatimin e tyre.
- Përdorimi i fondeve kombëtare, të BE-së ose fondeve të tjera publike për projektet kapitale duhet të lidhet me një strategji të qartë me objektiva dhe tregues të përcaktuar mirë për

¹²² Avramovski, Darko. *Vlerësimi i legjisllacionit kundër korrupsionit - Raport mbi Ligjin për Energjinë*. Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. <https://www.antikorupcija.mk/uploads/records/file/5%20APL%20Energetika%20%20MK.pdf>

monitorimin e zbatimit që rezulton nga një debat i hapur publik. Gjithashtu duhet të ketë llogaridhënie të plotë publike në lidhje me shpenzimin e fondeve.

- Informacione të detajuara mbi projektet e infrastrukturës kapitale, duke përfshirë analizën kosto-përfitim, duhet të bëhet publik në kohën e duhur¹²³.

Siç u tha, hapësira e madhe për rregullimin e çështjes ligjore me akte nënligjore paraqet një rrezik në rritje të korrupsionit dhe konfliktit të interesit, veçanërisht kur bëhet fjalë për rregullimin e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme, të cilat, përveç dispozitave themelore, rregullohen praktikisht tërësisht me disa akte nënligjore. Rekomandimi në këtë kontekst është që të integrohen shumica e dispozitave të akteve nënligjore në vetë Ligjin për energjetikë, ose të miratohet një Ligj i ri dhe i veçantë për prodhimin e energjisë nga burimet e rinovueshme¹²⁴. Përveç kësaj, ekziston nevoja për rishikim të plotë të tarifave preferenciale që u jepen prodhuesve të energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme. Periudha e gjatë prej 20 vjetësh për të cilën jepen këto tarifa preferenciale mund të rrisë rreziqet e korrupsionit në procedurat për dhënien e këtyre tarifave¹²⁵.

Në kuadër të rregullimit të prodhimit të energjisë nga hidrocentralet e vogla (HCV), organizatat e shoqërisë civile konkludojnë se një pjesë e madhe e akteve nënligjore që rrjedhin nga ligjet që rregullojnë këtë sferë nuk janë miratuar, veçanërisht aktet nënligjore që rrjedhin nga Ligji për ujërat. Prandaj, shteti ende nuk ka krijuar një sistem adekuat për monitorimin e trupave ujorë, veçanërisht monitorimin e prodhuesve të energjisë elektrike si pjesë e veçantë e monitorimit. Gjithashtu, ende nuk është përcaktuar metodologjia përmes së cilës do të llogaritet "rrjedha minimale e pranueshme e ujit", si dhe "minimumi biologjik", gjë që rezulton që këto kriterë në lejet për përdorimin e ujit, të mos korrespondojnë me kushtet reale. Legjislacioni maqedonas nuk parashikon sanksion për mos miratimin e akteve nënligjore, përfshirë dokumentet strategjike. Kjo çështje duhet të jetë pjesë e mbrojtjes administrativo-gjyqësore, por ende nuk është ngritur asnjë padi në Gjykatën Administrative që i kërkon gjykatës të vendosë për këto çështje dhe nuk ka një jurisprudencë të përcaktuar. Gjykata Administrative duhet të vendosë për çdo padi të ngritur për këto çështje dhe të ketë rol proaktiv¹²⁶.

Kur bëhet fjalë për procedurat e dhënies së koncesioneve, organizatat e shoqërisë civile rekomandojnë që shteti të përgatisë të gjitha dokumentet që duhet t'i paraprijnë publikimit të thirrjes për koncesione, në veçanti dispozitat për kryerjen e procedurave për ndikim mbi mjedisin jetësor (vlerësimi strategjik mjedisor dhe vlerësimi i ndikimit mbi mjedisin jetësor)¹²⁷.

U konstatua se Ligji për ujërat, si ligj i veçantë në lidhje me Ligjin për koncesionet dhe partneritetin publik privat (LKPPP), si dhe Propozim - ligji për koncesionet e mallrave me interes të

¹²³ Mineva, Daniela; Vladimirov, Martin; Rangelova, Konstantsa; Fazekas, Mihaly; Hern, Peter dhe Bence Toth. 2022. *Public Procurement Integrity in Southeast Europe: Mechanisms, Red Flags, and State-Owned Enterprises in the Energy Sector*.

¹²⁴ Avramovski, Darko. *Vlerësimi anti-korrupsion i legjislacionit - raport mbi Ligjin për energjetikë*.

¹²⁵ Ibid.

¹²⁶ Trpevski, Bojan; Çolloviq - Leshoska, AKSH; Gjorgji Mitrevski. 2022. *Analiza e funksionimit të hidrocentraleve të vegjël*.

¹²⁷ Ibid.

përgjithshëm (LKMIP), kompenson hendekun që kanë këto dy ligje në lidhje me pjesëmarrjen e publikut, duke parashikuar një debat publik të detyrueshëm në fazën e përgatitjes, pra pas publikimit të studimit të fizibilitetit për dhënien e koncesioneve për përdorimin e ujërave. LKPPP dhe LKMIP duhet të përmbajnë dispozita për pjesëmarrjen publike, në mënyrë që publiku të ketë të drejtë të marrë pjesë gjatë dhënies së koncesioneve¹²⁸.

Mungesa e standardeve dhe kriterëve për mbrojtjen e mjedisit jetësor në ndonjë prej akteve që lidhen me procedurën për marrjen e statusit të prodhuesi preferencial i cili mund të përdorë masa mbështetëse, rrit më tej rreziqet për korrupsion. Rekomandohet miratimi i një ligji të veçantë për burimet e rinovueshme të energjisë që do të rregullonte në mënyrë më të detajuar kriteret dhe standardet minimale që duhet të përmbushen në drejtim të mbrojtjes së mjedisit. Një alternativë ndaj kësaj do të ishte vendosja e rregullave dhe standardeve më të hollësishme për matjen e efekteve të centraleve për prodhimin e energjisë elektrike mbi mjedisin jetësor, si dhe detyrimet dhe kompetencat në lidhje me ruajtjen e mjedisit¹²⁹.

Është e nevojshme të forcohet kontrolli mbi Komisionin Rregullator për Energjetikë nga Kuvendi, si dhe kontrolli mbi vendimet e marra në nivelin e aktit nënligjor, veçanërisht nëse nuk iniciohet miratimi i një ligji të veçantë që rregullon prodhimin e energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme¹³⁰.

Në drejtim të forcimit të transparencës dhe llogaridhënies së KRE-së, rekomandohet mbajtja e rregullt e procesverbaleve të debateve publike, si dhe të seancave të rregullta dhe përgatitore; publikimi i rregullt dhe në kohë i draft rregulloreve, me mundësinë e paraqitjes së komenteve me shkrim nga palët e interesuara në faqen e internetit të KRE-së; si dhe publikim i rregullt dhe në kohë i planeve financiare vjetore në faqen e internetit¹³¹.

7.2. Zbulimi i ekonomisë së fshehur

Për një pasqyrë dhe kuptim më të mirë të ekonomisë së padukshme, rekomandohet që Entet Nacionale të Statistikave të zbatojnë metodologjinë e Eurostat/ OECD për të mbuluar ekonominë e padukshme dhe për t'u përshtatur me produktin e brendshëm bruto dhe për të publikuar përshkrime në kohë dhe gjithëpërfshirëse të rëndësisë së humbur sipas llojit të sektorit të pashfrytëzuar dhe ekonomik. Statistikat pasqyruese (reflektuese) duhet të përdoren për të

¹²⁸ Trpevski, Bojan. 2022. *Pjesëmarrja e publikut në procedurat e përdorimit të ujit për hidrocentralet e vogla*. Shkup: Shoqata e juristëve të rinj të Maqedonisë. <https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022>

¹²⁹ Avramovski, Darko. *Vlerësimi anti-korrupsion i legjislacionit - raport mbi Ligjin për energjetikë*.

¹³⁰ Ibid.

¹³¹ Zhupanoska, Diana; Goran Lazarov. 2018. *Analiza e punës së Komisionit Rregullator të Energjisë*. Shkup: Eurothink – Qendra për Strategji Evropiane, Shkup. <https://eurothink.mk/2018/07/27/%Do%Bo%Do%B>

kalibruar statistikat e tregtisë ndërkombëtare dhe të përdoren si zëvendësim për statistikat në lidhje me evazionin e tatimit tregtar dhe kontrabandimit¹³².

8. Mbrojtja e mjedisit jetësor

8.1. Forcimi i kuadrit ligjor dhe institucioneve në fushën e mbrojtjes së mjedisit jetësor

Lidhur me Ligjin për mjedisin jetësor (LMJ), një vërejtje e përgjithshme u bë nga organizatat e shoqërisë civile, e cila kalon nëpër disa dispozita dhe i referohet faktit se të gjitha procedurat, kërkesat, mënyra dhe kushtet e marrjes së lejeve, si dhe afatet rregullohen nga diskrecioni i plotë i Ministrit që udhëheq organin e administratës shtetërore përgjegjëse për fushën e mjedisit jetësor. Ligji mund të ofrojë dispozita më të hollësishme dhe më të sakta që nuk do të pengonin fleksibilitetin dhe shpejtësinë e veprimit të ministrisë kompetente dhe organeve të saj, gjë që do të zvogëlonte rreziqet e korrupsionit dhe konfliktit të interesit për shkak të autorizimeve të mëdha diskrecionale. Në këtë drejtim, është e nevojshme në LMJ të vendosen disa standarde minimale, rregullore, si dhe kufizime të tjera në kompetencat diskrecionale të ministrit, veçanërisht në drejtim të sigurimit të kushteve bazë për zgjedhjen e anëtarëve të komisioneve¹³³.

Në kuadër të transparencës, u përcaktua se LMJ nuk parashikon publikimin e detyrueshëm të dokumenteve nga procedura e miratimit të elaborateve për mbrojtjen e mjedisit jetësor. Në këtë drejtim, organizatat e shoqërisë civile kanë bërë rekomandim për të ndryshuar nenin 24 të LMJ-së, në mënyrë që të gjithë palët e interesuara të kenë një pasqyrë më të mirë të këtij procesi¹³⁴.

Në kontekst të lëshimit të lejeve ekologjike të integruara, është e nevojshme të përmirësohen dispozitat në lidhje me dhënien e lejeve ekologjike të integruara, veçanërisht në lidhje me vendosjen e mekanizmave mbrojtëse që do të kufizonin dhe parandalonin abuzimin e mundshëm të kompetencave diskrecionale të të gjitha subjekteve të përfshira në këtë proces, veçanërisht të Ministrisë së Mjedisit Jetësor, si dhe njësive të vetëqeverisjes lokale¹³⁵.

Rekomandohet që të bëhen intervenime në dispozitat ligjore që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese dhe mbikëqyrje të tjera mbi zbatimin e ligjit, të cilat do të rrisnin efikasitetin e ligjit në praktikë dhe në këtë mënyrë mbrojtjen dhe avancimin e mjedisit jetësor. Në këtë kontekst, është veçanërisht e rëndësishme të specifikohet se në cilat raste palët e interesuara

¹³²Qendra për Studimin e Demokracisë. 2016. *Fuqia hije: Vlerësimi i korrupsionit dhe ekonomisë së fshehur në vendet e Evropës Juglindore*. <https://mcms.mk/images/docs/2016/mokj-od-senka.pdf>

¹³³ Avramovski, Darko; Emilija Spasovska. 2021. *Kontroll antikorrupsion i Ligjit për mjedisin jetësor*. Shkup: Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup. <https://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2023/05/52-APZZS-2021.pdf>

¹³⁴ Trpevski, Bojan. 2022. *Pjesëmarrja e publikut në procedurat për përdorimin e ujit për hidrocentralet e vogla*.

¹³⁵ Avramovski, Darko; Emilija Spasovska. 2021. *Kontroll antikorrupsion i Ligjit për mjedisin jetësor*.

mund të nisin proceset gjyqësore, veçanërisht duke pasur parasysh joefikasitetin e lartpërmendur të shërbimeve të inspektimit¹³⁶.

Për të optimizuar përdorimin e burimeve njerëzore në Ministrinë kompetente, organizatat e shoqërisë civile rekomandojnë përgatitjen e një analize funksionale të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor, e cila do të përfshijë një analizë të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të Ministrisë së Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor dhe Rregullores për Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Mjedisit Jetësor dhe Planifikimit Hapësinor¹³⁷.

Disa nga rekomandimet në këtë sektor i referohen drejtpërdrejt organizimit të brendshëm, kompetencave dhe kapaciteteve të institucioneve kompetente. Prandaj, në lidhje me punën e Policisë Pyjore (PP), rekomandimet i referohen forcimit të institucionit në disa fusha¹³⁸:

- a. PP ka nevojë për shumë punonjës, të cilët do të jenë relativisht të rinj, të përgatitur fizikisht dhe të trajnuar profesionalisht dhe të angazhuar për mbrojtjen e pyjeve. Numri aktual i të punësuarve është i pamjaftueshëm për mbrojtjen e suksesshme të fondit pyjor në Maqedoninë e Veriut;
 - b. Është e nevojshme të respektohen plotësisht të gjitha përfitimet/befificionet, puna jashtë orarit të rregullt, ndërrimet e natës dhe të drejtat shtesë që rrjedhin nga kontratat e punës së punonjësve të policisë;
 - c. Është e nevojshme të sigurohen pajisje të reja, duke përfshirë automjete, uniforma, këpucë, armë dhe aksesore të mjaftueshëm që do të ofrojnë një avantazh shtesë ndaj shkelësve të ligjit (syze për shikim natën, dronë, kamera lëvizëse, etj.) dhe tu shpërndahen oficerëve të policisë pyjore sa më shpejt të jetë e mundur;
 - d. Të gjithë punonjësit aktualë dhe të rinj të PP-së duhet t'i nënshtrohen formimit të plotë profesional, i cili do të rrisë aftësitë e tyre fizike dhe njohëse në luftën kundër krimit të organizuar.
2. Rekomandime për Ndërmarrjen Publike Pyjet Nacionale (NPPN)¹³⁹:
- a. Aktivizimi i menjëhershëm i linjës telefonike joaktive për raportimin anonim të prerjeve të paligjshme dhe transportit të pemëve të prera në mënyrë të paligjshme.
 - b. Autonomi më e madhe organizative e njësive rajonale të NPPN.
 - c. Futja e mekanizmit të kontrollit të brendshëm për punën e punëtorëve

¹³⁶ Fakiq, Sabina; Filkov, German; Mitevski, Marko dhe Pavlinka Strezoska. 2022. *Dokument me rekomandime për nxitjen e zbatimit të prokurimit publik "të gjelbër" dhe parandalimin e korrupsionit në proces*. Shkup: Qendra për komunikime civile. <https://www.antikorupcija.mk/wp-content/uploads/2023/>

¹³⁷ Trpevski, Bojan. 2022. *Kapacitetet institucionale të sektorit të ujit për menaxhimin dhe mbrojtjen e ujit*. Shkup: Shoqata Maqedonase e Avokatëve të Rinj. https://myla.org.mk/wp-content/uploads/2022/12/Zastita-na-vodite_analiza.pdf

¹³⁸ Stefanovski, Ivan; Danillovska, Aleksandra; Mila Georgievska. 2021. *Shkatërrimi i së ardhmes sonë: format/modelet e krimit të organizuar në prerjet e paligjshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Shkup: Qendra për Strategji Evropiane - EUROTINK. <https://eurothink.mk/wp-content/uploads>

¹³⁹ Demiri, Mariglen. 2021. *Pyjet e degraduara: hartëzimi i krimit të organizuar në formën e prerjeve pa ligj*. Shkup: EUROTINK - Qendra për Strategji Evropiane - Shkup. <https://eurothink.mk/wp-content>

3. Rekomandime për Trupin Koordinues për Parandalimin e Krimit të Prerjes së Paligjshme¹⁴⁰:
 - a. Përfshirja e përfaqësuesve të gjykatave themelore penale dhe prokurorive publike nga i gjithë vendi.
 - b. Miratimi i strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për mbrojtjen e pyjeve, ku do të përfshihen edhe ekspertë nga Fakulteti i Pyjeve.
 - c. Ndryshime dhe plotësime në Ligjin për pyjet në fushën e kompetencave të policisë pyjore, veçanërisht në përcaktimin se në cilat kushte do të parashikohet përgjegjësia penale, dhe cilët persona që regjistrohen në vend si kryerës të prerjeve të paligjshme dhe shkatërrim të pyjeve, do të sanksionohen me kundërvajtjeje.
 - d. Përfshirja e Fakultetit të Pyjeve në të gjitha aktivitetet që lidhen me pylltarinë dhe fondin pyjor të vendit.

4. Rekomandime për MPB-në¹⁴¹:
 - a. Bashkëpunim më dinamik dhe i rregullt me PP-në, i cili do të kontribuojë në përgjigje më të madhe ndaj kërkesave për përforsimin e veprimeve të PP-së në terren.

5. Rekomandime për Prokurorinë Publike Themelore dhe Gjykatat Themelore¹⁴²:
 - a. Pranimi i kallëzimeve penale dhe përcjellja e tyre në gjykata, duke prezantuar kështu një qëndrim më serioz ndaj veprave penale që i përkasin fushës së krimit mjedisor, përkatësisht ndjekjes penale të autorëve të këtyre krimeve.
 - b. Arkivimi i duhur i lëndëve të tilla dhe krijimi i të dhënave statistikore lidhur me "shkatërrimin e pyjeve" nga KP.

6. Rekomandime për vetëqeverisjen lokale dhe institucionet e tjera përkatëse¹⁴³:
 - a. Krijimi i PPL-së në kuadër të komunave ku problemi i prerjes dhe tregtisë së paligjshme të lëndëve drusore të fituara përmes prerjes së paligjshme do të jetë me përparësi për zgjidhje.
 - b. Përfshirja e përfaqësuesve nga Prokuroritë kompetente vendore, Gjykatat, SPB pranë MBP, Komunitetet Lokale, filialet e NPMP (Rokjtar të pyjeve – Sektori i

140 Ibid.
141 Ibid.
142 Ibid.
143 Ibid.

Në drejtim të mbrojtjes së mjedisit jetësor, rekomandohet gjithashtu të prezantohet një seksion i veçantë raportimi në faqen kryesore të autoritetit kompetent që do të ofrojë informacione si qytetarët mund të paraqesin ankesë për dëmtimin e mjedisit jetësor ose sjelljen korruptive të zyrtarëve qeveritarë.¹⁴⁴ Rekomandohet gjithashtu hapja e një adrese të dedikuar emaili ku qytetarët mund të raportojnë probleme me korrupsionin në mjedisin jetësor.¹⁴⁵

Lidhur me Ligjin për mbrojtjen e natyrës, vërehet se në procesin e shpalljes së një zone të mbrojtur, në përgatitjen e studimeve të valorizimit është e nevojshme të identifikohen dhe të përfshihen në kohë dhe në mënyrë transparente të gjithë aktorët, si institucionet ashtu edhe të gjitha subjektet që jetojnë dhe punojnë në territorin e zonës së mbrojtur.¹⁴⁶

Ligji për menaxhimin e mbetjeve rekomandon¹⁴⁷ ndarjen e kompetencave për hartimin e politikave në fushën e menaxhimit të mbetjeve dhe zbatimin e ligjeve dhe dokumenteve të tjera të menaxhimit të mbetjeve. Gjithashtu theksohet se menaxhimi rajonal i mbetjeve nuk është funksional, prandaj ka nevojë për mbështetje institucionale, financiare dhe të personelit për të krijuar një sistem rajonal efikas, efektiv dhe me kosto efektive të menaxhimit të mbetjeve.

Së fundi, organizatat e shoqërisë civile kanë disa rekomandime të përgjithshme në lidhje me mbrojtjen e mjedisit¹⁴⁸:

- c. Sigurimi i kapaciteteve teknike për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese në përputhje me kompetencat brenda kuadrit ligjor dhe sigurimi i ndërveprimit me institucionet e tjera kompetente për të siguruar efektivitetin në zbatimin e vendimeve.
- d. Forcimi i kapaciteteve të organeve hetimore (prokurorëve publikë, policisë dhe organeve të tjera) si dhe gjyqtarëve për zbatimin e ligjeve në fushën e mjedisit jetësor, për zbulimin dhe ndjekjen penale të veprave penale në fushën e mjedisit jetësor.
- e. Forcimi i kapaciteteve të gjyqtarëve në procedurat gjyqësore që synojnë mbrojtjen e mjedisit jetësor si interes publik mbi parimin e urgjencës, parandalimit dhe përgjegjësisë së subjekteve për dëmtim mbi mjedisin jetësor.

¹⁴⁴ Lazhetaq, Gordana; Igjnjatoviq, Jovanka; Goxho, Aleksandar; Dedinec, Aleksandar; Aleksov. 2021. *Si të arrihet drejtësia mjedisore efikase dhe efektive?*. Shkup: Qendra për Hulumtime dhe Analiza Ligjore. <https://cpia.mk/wp-content/u>

¹⁴⁵ Ibid.

¹⁴⁶ Mihajlov, Marjan; Çolloviq- Leshoska, Ana; Mujoska - Trpevska, Elena; Pavlovska-Daneva, Ana; Zharko Haxhi-Zafisov. 2021. *Analiza e boshllëqeve dhe mangësive - sfidat dhe mundësitë për kuadrin institucional dhe ligjor të mjedisit jetësor*. Shkup: Qendra për Hulumtime dhe Analiza Ligjore. <https://cpia.mk/wp>

¹⁴⁷ Ibid.

¹⁴⁸ Ibid.

9. Urbanizëm

9.1. Përmirësimi i kuadrit ligjor për reduktimin e rreziqeve të korrupsionit në urbanizëm

Në kuadër të sektorit të planifikimit urban, organizatat e shoqërisë civile theksojnë se mbikëqyrja e vazhdueshme mbi zbatimin e Ligjit për planifikim urban është e nevojshme, duke ndjekur një metodologji të qartë me tregues të vendosur që janë të rëndësishëm për matjen e suksesit të zbatimit të Ligjit ose për krijimin e ndryshimeve ose plotësimeve të mundshme në tekstin ligjor.¹⁴⁹

Nga vetë teksti i Ligjit për planifikim urban mund të konkludohet se ai mund të shkarkohet nga pjesë të tekstit, dhe disa dispozita mund të riformulohen për të përmirësuar saktësinë dhe dukshmërinë e vetë tekstit. Në këtë drejtim, mund të theksohet se Ligji (në pjesë) rregullon çështjet në detaje, duke lënë vetëm një hapësirë të vogël për përpunimin shtesë të dispozitave me akte nënligjore, ndërsa në pjesë të caktuara Ligji përcakton vetëm në përgjithësi disa standarde ose procedura. Si pasojë, boshllëqet dhe mosveprimet ligjore mund të lindin nëse aktet nënligjore nuk arrijnë të rregullojnë në mënyrë adekuate çështjet, duke lënë në të njëjtën kohë hapësirë të madhe të panevojshme që ekzekutivi të jetë në gjendje të rregullojë çështjet e planifikimit hapësinor me aktet nënligjore.¹⁵⁰

Shumë nga dispozitat rregullohen në mënyrë më të detajuar nga Rregullorja për Planifikim Urban, si rezultat i së cilës është shumë e gjerë, dhe është një akt nënligjor që shkakton konfuzion për shkak të fushës së tij të veprimit, pasi rrit rrezikun e konfliktit të dispozitave ligjore. Kjo përfshin dy pyetje: e para, e cila i referohet nevojës për një rregullim kaq të gjerë të sektorit urban me akt nënligjor, dhe e dyta, e cila i referohet nevojës për t'i rregulluar këto çështje me vetëm një akt. Para së gjithash, është e nevojshme të rishikohet se cilat dispozita do të mbulohen nga akti nënligjor dhe deri në çfarë mase do të rregullohen prej tij, në mënyrë që të parandalohet ndikimi i pushtetit ekzekutiv në sektor, dhe në të njëjtën kohë të rritet pjesëmarrja publike dhe qytetare, e cila është shumë më e lartë kur bëhet fjalë për miratimin e ligjeve sesa miratimi i akteve nënligjore.¹⁵¹

Në këtë kontekst, është e rëndësishme të përmirësohen përkufizimet ligjore, si dhe të futen përkufizime të qarta dhe të sakta për të gjitha termat e përdorura në ligj, dhe në veçanti për zonën

¹⁴⁹ Avramovski, Darko. 2021. *Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në fushën e urbanizmit në nivel lokal*. Shkup: Koalicioni të gjithë për gjykime të drejta. <https://all4fairtrials.org.mk/wp-content/uploads/2023/05/51-PRK-2021.pdf>

¹⁵⁰ Ibid.

¹⁵¹ Avramovski, Darko. 2021. *Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në fushën e urbanizmit në nivel lokal*.

e ndërtuar bruto dhe neto, si dhe për përcaktimin se cila ministri është organi kompetent i administratës shtetërore për planifikimin urban dhe hapësinor.¹⁵²

Gjithashtu është e nevojshme të specifikohen më tej dispozitat në lidhje me procedurat për përgatitjen dhe miratimin e planeve urbanistike, si dhe pezullimin e tyre. Është e nevojshme të përfshihen dispozita që do të rregullonin në detaje pjesëmarrjen e publikut, mënyrat e pjesëmarrjes, kriteret me të cilat vlerësohen propozimet për planet urbane të dhëna nga qytetarët, qasja e publikut në dokumentet dhe të dhënat nga fazat e mëparshme e procedurave për përgatitjen dhe miratimin e planeve urbanistike.¹⁵³

Procedura e pezullimit të planeve urbanistike sjell me vete dispozita të paqarta, dhe nganjëherë dispozita që mund të jenë krejtësisht kundër produktive kur bëhet fjalë për parandalimin e dëmeve të mëdha në praktikë dhe përshtatjen e duhur të planeve urbanistike sipas kushteve në terren.¹⁵⁴ Prandaj, është e nevojshme të përcaktohen dispozitat për pezullimin e planeve urbanistike, veçanërisht në fushën e fillimit të procedurave të pezullimit dhe vërtetimit të dëmit. Prandaj, këto dispozita duhet të jenë gjithashtu në përputhje me nenin 47, përkatësisht të përcaktohet përgjigje e qartë në pyetjen se çfarë në situata kur komuna do të dështojë të riparojë dëmin me miratimin e një plani të ri urbanistik, ndërsa përcaktohet se dëmi është shkaktuar për shkak të mungesës së të dhënave të siguruar nga një autoritet i caktuar. Pyetja që lind është nëse në këtë rast përgjegjësia, në përputhje me nenin 22, bartet nga komuna ose, në përputhje me nenin 47, nga organi që nuk ka paraqitur të dhënat.¹⁵⁵

Ekziston një nevojë serioze për të harmonizuar Ligjin për ndërtimin dhe Ligjin për tokën ndërtimore me Ligjin për planifikimin urban si dhe me standardet dhe procedurat e reja që ai parashikon nga njëra anë, dhe nga ana tjetër, duhet të zvogëlohet ndikimi i dispozitave të këtyre ligjeve në Ligjin për planifikim urban. Në këtë kontekst, është i rëndësishëm procesi i harmonizimit të Ligjit për gjelbërim urban dhe ofrimi i mekanizmave të posaçëm të garancisë për zbatimin e këtij ligji në praktikë, si dhe rishikimi i procesit të decentralizimit, duke nxitur pavarësinë financiare të njësive të vetëqeverisjes lokale.¹⁵⁶

Rekomandime për Ligjin për planifikim urbanistik¹⁵⁷:

- a. Përcaktimi i titullit, i cili është organi që formon komisionin për planifikim urbanistik. Ligji përcakton vetëm: "ministri i organit të administratës shtetërore përgjegjës për rregullimin e hapësirës". (nuk ka përcaktim se cili organ me emrin e saktë në fjalë).

¹⁵² Ibid.

¹⁵³ Ibid.

¹⁵⁴ Gjorgjieva– Antonijević, Sirma; Slagjana Taseva. 2021. *Analiza e kuadrit ligjor në fushat e planifikimit hapësinor, urbanizmit dhe ndërtimit me rreziqet e mundshme të korrupsionit dhe metodologjinë për ndjekjen e rekomandimeve*. Shkup : Transparency International - Maqedoni.

¹⁵⁵ Avramovski, Darko. 2021. *Vlerësimi i rreziqeve të korrupsionit në fushën e urbanizmit në nivel lokal*.

¹⁵⁶ Gjorgjieva– Antonijević, Sirma; Slagjana Taseva. 2021. *Analiza e kuadrit ligjor në fushat e planifikimit hapësinor, urbanizmit dhe ndërtimit me rreziqet e mundshme të korrupsionit dhe metodologjinë për ndjekjen e rekomandimeve*.

¹⁵⁷ Ibid.

- b. Të përcaktohet nëse miratuesi i planit është i detyruar sipas mendimit të ministrit. Miratimi i rregullimit urgjent ligjor në rast të dokumenteve kontradiktore - kur elaborati i Komisionit për Urbanizëm është në kundërshtim me mendimin e organit të administratës shtetërore
- c. Përcaktimi se cilit autoritet i bie dëmi dhe pasojat e dëmshme në rast të pezullimit të planit. Nëse nuk veprohet në lidhje me vërejtjet dhe mangësitë nuk hiqen, duhet të tregohet se cili është sanksioni për organin që nuk ka vepruar në kohën e duhur.
- d. Kufizimi i kompetencave diskrecionale të Ministrit të Transportit dhe Lidhjeve. Përcaktimi i kompetencave të organeve të shumta që do të mund të lëshojnë licenca, por të kenë kontroll dhe bashkëpunim ndërmjet tyre, me qëllim uljen e kompetencave diskrecionale të ministrit.
- e. Nuk ka nevojë për afate të tilla të shkurtra për miratimin e një plani të ri të detajuar urbanistik (PDU), përkundrazi, PDU-të e reja duhet të jenë efektive, dhe për shkak të afatit të shkurtër, lind mundësia e një procedure që nuk është në përputhje me ligjin.
- f. Reduktimi i kompetencës diskrecionale të kryetarit të komunës, përkatësisht heqja e të drejtave të marrë vendimin për përzgjedhjen e zhvilluesit të planit dhe në të njëjtën kohë të formojë një komision për vlerësimin e ofertave. Përcaktimi i përbërjes së komisionit, sa anëtarë duhet të ketë komisioni, gatishmëria e tyre profesionale si dhe përvoja e punës.
- g. Autoriteti duhet të provojë se nuk ka pasur të dhënat e nevojshme nëse nuk i ka siguruar, me qëllim të përfundojë të gjithë procedurën e planifikimit urban. Nëse nuk provohet përgjegjësia, përgjegjësia duhet të bartet nga drejtori ose drejtuesi i organit, dhe përcaktimi i sanksionit, ndaj organit dhe personit përgjegjës që e përfaqëson atë.
- h. Sinkronizimi i dispozitave kalimtare dhe përfundimtare, nuk ka asnjë lidhje që këto dispozita të interpretohen si një tërësi.

Rekomandime për Rregulloren për Planifikim Urban¹⁵⁸:

- a. Rregullorja, në vetvete, paraqet rrezik korrupsioni dhe konflikt interesi, për shkak të mundësisë së interpretimeve dhe konflikteve të ndryshme në praktikë. Ligji duhet të jetë burimi i së drejtës për të minimizuar nevojën për ndërhyrje në tekst, të kufizojë ndikimin e rregulloreve të tjera në urbanizëm, si dhe për të përcaktuar kompetencat e të gjitha autoriteteve, organeve dhe institucioneve të përfshira në procesin e planifikimit urban. Është e nevojshme të sinkronizohen dispozitat ligjore, për të shmangur miratimin e rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore.

¹⁵⁸ Ibid.

- b. Është e nevojshme të sinkronizohen dispozitat ligjore, për të shmangur miratimin e rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore. Megjithatë, sipas situatës aktuale, do të jetë e nevojshme të miratohet një rregullore e re për të sinkronizuar normat ligjore.
- c. Dispozitat e papërcaktuara ligjore cenojnë parimin e qeverisjes së mirë që do të kontribuojë në rritjen e kompetencave diskrecionale dhe shfaqjen e korrupsionit. Kërkohet një përkufizim kategorik i asaj që nënkuptohet me sipërfaqen bruto.

9.2. Rreziqet e korrupsionit në ndërtimtari

Në kuadër të nënsektorit ndërtimtari është konkluduar se që nga miratimi i ligjit për tokën ndërtimore në vitin 2015, ky akt i është nënshtruar shtatë ndryshimeve. Organizatat e shoqërisë civile vërejnë nevojën e sinkronizimit të dispozitave ligjore, me qëllim minimizimin e nevojës për miratimin e rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore¹⁵⁹.

Ligji për ndërtim nga viti 2009 e deri më tani ka pasur 35 ndryshime. Në funksion të kësaj, është e nevojshme të sinkronizohen dispozitat ligjore, për të minimizuar nevojën për miratimin e rregulloreve dhe akteve të tjera nënligjore. Për sa i përket rreziqeve të korrupsionit, është përcaktuar ekzistenca e mundësisë së prolongimit së procedurës për lëshimin e lejes së ndërtimit nga personat e autorizuar, pa mundësinë e fillimit të procedurës. Në këtë kontekst, rekomandohet zvogëlimi i kompetencave diskrecionale të pushtetit lokal, si dhe kontrolli i rreptë nga një organ që është i pavarur nga pushteti lokal nëse vonohet procedura për marrjen e lejes së ndërtimit¹⁶⁰.

Në pajtim me Ligjin për tokën ndërtimore, çdo subjekt që zotëron të paktën 30% të një trualli të veçantë ka të drejtë të bëjë blerjen e të gjithë truallit, me kusht që të jetë në pronësi të shtetit. Për zbatimin e kësaj procedure, lidhet një marrëveshje e drejtpërdrejtë me Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Ekziston mundësia që pronari të bëjë ndarjen dhe bashkimin e parcelës. Duke marrë parasysh faktin se procedura e blerjes së pjesës tjetër të truallit kryhet nëpërmjet një marrëveshje të drejtpërdrejtë, Transparency International në analizën e saj konkludon se ka një përqendrim të madh të pushtetit në Ministrinë e Transportit dhe Lidhjeve. Rreziku i korrupsionit u identifikua nëpërmjet krijimit të një plani urbanistik dhe vizatimit të parcelave ndërtimore për një person që fiton qëllimisht 30% të pronësisë në mënyrë që të formojë të gjithë parcelën. Në drejtim të kësaj, rekomandohet zvogëlimi i kompetencave diskrecionale të Ministrisë së Transportit dhe Lidhjeve në Ligjin për tokën ndërtimore, pasi ekziston rreziku i korrupsionit me qëllim bashkimin, blerjen, përfundimin e një parcele ndërtimi, si dhe rritjen e transparencës në procesin e përfundimit të parcelave në përputhje me këtë mundësi ligjore¹⁶¹.

¹⁵⁹Gjorgjieva- Antonijević, Sirma; Slagjana Taseva. 2021. *Analiza e kuadrit ligjor në fushat e planifikimit hapësinor, urbanizmit dhe ndërtimit me rreziqet e mundshme të korrupsionit dhe metodologjinë për ndjekjen e rekomandimeve.* <https://transparency.mk/wp-content/up>

¹⁶⁰ Ibid.

¹⁶¹ Ibid.

10. Lista e organizatave të shoqërisë civile, gjetjet dhe rekomandimet e të cilave janë shënuar në tekst

1. Asociacioni i Iniciativave Zhvillimore ZENIT – Shkup
2. EUROTINK - Qendra për Strategji Evropiane
3. Instituti për Demokraci "Societas Civilis" - Shkup
4. Instituti për të Drejtat e Njeriut
5. Koalicioni i shoqatave të qytetarëve "Të gjithë për gjykim të drejtë"
6. Shoqata maqedonase e juristëve të rinj
7. Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar.
8. Southeast European Leadership for Development and Integrity - SELDI
9. Transparency International Macedonia
10. Fondacioni Shoqëria e Hapur - Maqedoni
11. Fondacioni "Metamorfozis"
12. Qendra për Menaxhim me Ndryshime
13. Qendra për Komunikime Qytetare
14. Qendra për Kërkime dhe Analiza Juridike

Informacione rreth projektit

Qëllimi kryesor i projektit "Nxitja e debatit mbi llogaridhënien dhe antikorrupsionin" është të kontribuojë në proceset e reformave në Maqedoninë e Veriut duke forcuar rolin e Kuvendit në luftën kundër korrupsionit dhe krijimin e reformave në sundimin e së drejtës.

Në prag të zgjedhjeve parlamentare të vitit 2024, projekti do të bashkëpunojë me partitë politike dhe deputetët në mënyrë që të përfshijë diskursin publik të bazuar në fakte në dialogun politik dhe të stimulojë diskutime mbi përpjekjet gjithëpërfshirëse dhe efektive kundër korrupsionit. Në këtë drejtim, projekti do të ndër marrë aktivitete që synojnë riorganizimin e rekomandimeve kundër korrupsionit në programet zgjedhore të partive politike, avokimin për përfshirjen e përpjekjeve kundër korrupsionit në programet zgjedhore, forcimin e kapaciteteve të forumeve rinore të partive dhe organizimin e diskutimeve publike parazgjedhore me partitë politike në mënyrë që të fitojnë njohuri për masat e tyre kundër korrupsionit.

Përmes mundësisit të dialogjeve për politika midis partive politike, forumeve të tyre rinore, deputetëve dhe shoqërisë civile, projekti synon të arrijë tre objektiva specifike:

1. Forcimi i angazhimeve antikorrupsion në programet zgjedhore të partive politike si bazë për krijimin e reformave të bazuara në prova dhe inkurajimin e një konsensusi më të gjerë mbi prioritetet dhe veprimet e nevojshme për trajtim në mënyrë efektive me korrupsionin.

2. Forcimi i kapaciteteve të Kuvendit, veçanërisht të deputetëve, për angazhim në mënyrë aktive në aktivitete mbikëqyrëse dhe për të kontribuar ndjeshëm në vlerësimin dhe krijimin e Strategjisë Kombëtare Kundër Korrupsionit.

3. Mobilizimi i mbështetjes publike për përpjekjet antikorrupsion të bazuara në prova dhe presioni ndaj politikanëve dhe funksionarëve për të zbatuar politika dhe masa gjithëpërfshirëse.

Informacione rreth IDSCS-ë

IDSCS është think tank organizatë, që hulumton zhvillimin e qeverisjes së mirë, sundimin e ligjit dhe integritet evropiane të Maqedonisë së Veriut. IDSCS ka mision të ndihmojë përfshirjen qytetare në vendimmarrje dhe të forcojë kulturën participative politike. Përmes forcimit të vlerave liberale, IDSCS kontribuon në bashkëjetesën e diversiteteve.

Të dhëna për kontakt, për IDSCS

Adresa: rr. Miroslav Krlezha nr. 52/1 / 2, 1000 Shkup
Tel. nr./ faks: +389 2 3094 760,
posta elektronike: contact@idscs.org.mk

